



URDHËR

Nr. 12, Datë 02.02.2011

PËR SHPALLJEN E STATUTIT TË AKADEMISË SË ARTEVE

Në bazë të nenit 39 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, shkresën nr. 7753 prot., datë 31.01.2011 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nisur nga miratimi dhe nënshkrimi që ka bërë Ministri i Arsimit dhe Shkencës, dokumentit të Statutit të Akademisë së Arteve,

URDHËROJ


1. Shpalljen e Statutit të Akademisë së Arteve.
2. Të gjitha strukturat akademike dhe administrative të Akademisë së Arteve, zbatojnë dispozitat e Statutit të Akademisë së Arteve, gjatë veprimtarisë akademike dhe administrative, brenda Akademisë së Arteve dhe në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me tekstin e dokumentit miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës z. Myqerem Tafaj, në datë 31.01.2011.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
AKADEMIA E ARTEVE



dh. 87 Prot
02.02.2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
DREJTORIA E ARSIMIT TË LARTË DHE E KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. 753/3 Prot.

Tiranë, më 31.01.2011

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Petrit Malaj
Rektor i Akademisë së Arteve

TIRANË

I nderuar Z. Rektor,

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 27/1 prot., datë 19. 01. 2011, Ju përcjellim bashkëlidhur statutin e Akademisë së Arteve, të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SKËNDER UKU

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MIRATOHET



MINISTËR



AKADEMIA E ARTEVE

STATUTI

I

AKADEMISË SË ARTEVE

TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AKADEMIA E ARTEVE

STATUTI

I

AKADEMISË SË ARTEVE

(TEKSTI TËRËSOR)

TIRANË

PJESA E PARË

KREU I PARIME THEMELORE

Neni 1 Akademia e Arteve

1. Akademia e Arteve është Institucion publik i Arsimit të Lartë, me karakter akademik, artistik dhe shkencor.
2. Akademia e Arteve është person juridik, i pavarur dhe laik.
3. Akademia e Arteve ka strukturën e vet akademike dhe administrative, të miratuar nga organet drejtuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Statuti i Akademisë së Arteve është dokumenti bazë i veprimtarisë së Akademisë së Arteve. Statuti miratohet nga Senati Akademik me votat e 2/3 të anëtarëve.

Neni 2 Autonomia e Akademisë së arteve

1. Autonomia e Akademisë së Arteve shprehet në:
 - a. vetëqeverisjen e saj, për të organizuar strukturat e saj të brendshme dhe veprimtaritë e saj, nëpërmjet këtij statuti dhe rregulloreve, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b. të drejtën për hartimin dhe zhvillimin e pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;
 - c. të drejtën për të caktuar kritere të pranimit të studentëve në programet e studimeve;
 - ç. të drejtën për të mbledhur fonde dhe për të përfituar mjete materiale, sipas rregullave në fuqi, si dhe të drejtën për të realizuar marrëveshje të pavarura me Qeverinë ose organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore; të drejtën për të realizuar marrëveshje me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera, vendase ose të huaja, publike ose private; të drejtën për të administruar fondet publike e të ardhura të tjera, që disponon sipas mënyrës së përshkruar në ligj.
2. Liria akademike e Akademisë së Arteve shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë e kërkimit shkencor e lirinë e krijimit.
3. Veprimtaria e Akademisë së Arteve zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.
4. Shteti garanton paprekshmërinë e Akademisë së Arteve dhe të territorit të saj.
5. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose lejen e titullarit të Akademisë së Arteve. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit.

Neni 3 Misioni i Akademisë së Arteve

1. Misioni i Akademisë së Arteve përfshin:
 - a. Ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës;
 - b. Zhvillimin e mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
 - c. Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
 - ç. Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës.

- d. Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën; dh. Ndhmesën në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

Neni 4

Fakulteti në Akademinë e Arteve

1. Fakulteti është njësi kryesore, që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, në përfundim të të cilave përfitohet diplomë.
2. Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tre të tilla, nga të cilat dy departamente.
3. Fakulteti mund të jetë edhe i tipit të asociuar. Në fakultetet e asociuara bashkohen disiplina, të cilat nuk përbëjnë një specialitet të institucionit. Fakultetet e asociuara nuk lëshojnë diplomë.
4. Struktura e fakultetit, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i tij përcaktohen në këtë statut dhe në akte të tjera.

Neni 5

Departamenti në Akademinë e Arteve

1. Departamenti është njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive.
2. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.
3. Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj.
4. Departamenti ka të drejtë të organizohet në grupe mësimore e kërkimore. Këto organizime kanë të drejtë të kenë edhe karakter të përkohshëm. Titullarët e grupeve përzgjidhen me konkurrencë dhe emërohen nga dekani i fakultetit përkatës për një periudhë 4-vjeçare ose për periudhën që përputhet me kohëzgjatjen e funksionimit të grupit.

Neni 6

Përbërja e Akademisë së Arteve

1. Akademia e Arteve përbëhet nga Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.
2. Rektorati organizohet dhe funksionon sipas dispozitave të përcaktuara në këtë Statut.
3. Fakulteti i Muzikës përbëhet nga:
 - a. Departamenti i Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim;
 - b. Departamenti i Interpretimit.
4. Fakulteti i Artit skenik përbëhet nga:
 - a. Departamenti i Aktrimit dhe Regjisë së Filmit dhe Televizionit;
 - b. Departamenti i Regji-Skenografi-Koreografi-Teori e Arteve.
5. Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga:
 - a. Departamenti i Pikturës;
 - b. Departamenti i Skulpturës.

Neni 7

Shenjat dalluese të Akademisë së Arteve

1. Emri zyrtar i Akademisë së Arteve është “AKADEMIA E ARTEVE”.
2. Akademia e Arteve ka stemën e saj, e cila është sipas Lidhjes 1 të këtij Statuti.
3. Senati Akademik i Akademisë së Arteve miraton paraprakisht emrin zyrtar dhe stemën e akademisë së Arteve, apo ndryshimin e tyre. Shenjat dalluese të miratuara paraprakisht i propozohen Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nga Rektori i Akademisë së Arteve.
4. Akademia e Arteve ka vulën e vet zyrtare, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Vula ka diametër 30mm dhe përmban shënimet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË” dhe “AKADEMIA E ARTEVE”.

PJESA E DYTË

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRUESE TË AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 8

Organet drejtuese dhe administruese

1. Organe drejtuese dhe administruese në Akademinë e Arteve janë: senati akademik, rektorati, këshilli i administrimit, këshilli i etikës dhe këshilli i fakultetit.
2. Akademia e Arteve ka të drejtë të formojë dhe organe të tjera, në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e vet.

KREU I

SENATI AKADEMIK I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 9

Senati Akademik

1. Senati akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Akademisë së Arteve, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
2. Funkcionet kryesore të senatit akademik janë:
 - a. garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b. miraton planin disavjeçar të zhvillimit të institucionit dhe programin vjetor të veprimtarive të tij;
 - c. vendos me shumicën e votave të anëtarëve të tij projektbuxhetin e institucionit, pasi merr miratimin nga këshilli i administrimit;
 - ç. miraton ndarjen e burimeve financiare;
 - d. miraton projektstatutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij;
 - dh. miraton rregulloret e institucionit, që janë kompetencë e tij;
 - e. vlerëson dhe miraton programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre dhe hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësisve mësimore ose kërkimore;
 - ë. vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore;
 - f. vlerëson veprimtarinë mësimore-kërkimore të personelit akademik;
 - g. siguron që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha provimeve të bëhet në përputhje me standardet e institucionit, që garantojnë cilësinë dhe transparencën e duhur etj.
 - gj. miraton paraprakisht tarifën e regjistrimit dhe të studimeve në Akademinë e Arteve. Pas miratimit dhe nga këshilli i administrimit, tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit i propozohet për miratim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

- h. miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore, si dhe atë financiar, në një mbledhje të hapur për gjithë personelin akademik e administrativ dhe për studentët
3. Senati akademik kërkon mendimin e këshillit të administrimit për probleme që janë kompetencë e këtij të fundit.

Neni 10

Përbërja e Senatit Akademik

1. Anëtarët e Senatit Akademik, zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të institucionit në përputhje me ligjin dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve të Akademisë së Arteve.
2. Senati Akademik i Akademisë së Arteve përbehet nga 19 anëtarë. Anëtarët e Senatit Akademik për efekt të zgjedhjes, janë të ndarë si më poshtë:
 - a. Rektori i Akademisë së Arteve;
 - b. Dekanët e Fakulteteve të Akademisë së Arteve;
 - c. Tre përfaqësues të Fakultetit të Muzikës;
 - ç. Tre përfaqësues të Fakultetit të Artit Skenik;
 - d. Tre përfaqësues të Fakultetit të Arteve të Bukura;
 - dh. Tre përfaqësues të personelit Administrativ;
 - e. Tre përfaqësues të studentëve, nga një student për çdo Fakultet;

Neni 11

Mandati i Senatit Akademik dhe i anëtarëve të tij

1. Senati Akademik si organ kolegjal ka mandat 4 vjeçar.
2. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik fillon nga momenti i zgjedhjes dhe zgjat deri në përfundim të mandatit të Senatit Akademik.
3. Mandati i anëtarit të senatit akademik konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
 - a. Jep dorëheqjen si anëtar i senatit akademik;
 - b. Përfundon marrëdhëniet e punës me Akademinë e Arteve apo përfundon/ndërpret studimet në Akademinë e Arteve.
 - c. Vdes;
 - ç. Nuk merr pjesë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara gjatë një viti akademik;
 - d. Dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Senati Akademik konstaton vakancën e krijuar me anë të një vendimi deklarativ.
5. Vendi vakant i krijuar nga përfundimi në mënyrë të parakohshme i mandatit të një anëtari të Senatit Akademik, plotësohet me një person tjetër të zgjedhur nga i njëjti grup i anëtarëve të Akademisë së Arteve.
6. Zgjedhjet për plotësimin e vendit vakant në Senatin Akademik zhvillohen brenda 3 javëve nga data e vendimit për konstatimin e vakancës.

Neni 12

Mbledhja e parë e senatit akademik

1. Në mbledhjen e tij të parë, senati akademik thirret nga Rektori i Akademisë së Arteve.
2. Në këtë mbledhje zgjidhet nënkryetari i senatit akademik, nga radhët e anëtarëve. Zgjedhja e nënkryetarit bëhet edhe në rastet e mbarimit të mandatit në mënyrë të parakohshme të anëtarit të zgjedhur nënkryetar, apo kur nënkryetari jep dorëheqjen nga kjo detyrë.

3. Nënkrjetari propozohet nga Kryetari i senatit akademik dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të senatit akademik.
4. Në mbledhjen e tij të parë senati akademik miraton propozimet e Rektorit për pozicionin e Zëvendësrektorit të Akademisë së Arteve.
5. Në mbledhjen e tij të parë senati akademik ngre komisionet e përhershme si më poshtë:
 - a. Komisioni i përhershëm për kurrikulat dhe degën mësimore,
 - b. Komisioni i përhershëm për kualifikimet dhe projektet shkencore-artistike;
 - c. Komisioni i përhershëm i ligjshmërisë dhe rregulloreve;
 - ç. Komisioni i përhershëm për çështjet financiare
6. Përbërja, të drejtat, detyrat dhe funksionimi i komisioneve të përhershme, përcaktohen nga senati akademik.
7. Senati akademik ngre Këshillin e Etikës, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Statut.

Neni 13

Thirrja e mbledhjes së senatit akademik

1. Senati akademik si rregull mbledhet të paktën një herë në muaj. Senati Akademik mund të miratojë rregulla shtesë, të cilat mund të përcaktojnë mbledhjen në një datë dhe orë të njëjtë, çdo muaj.
2. Mbledhja e Senatit akademik thirret nga:
 - a. Rektori (Kryetari i Senatit);
 - b. Nga anëtarë të senatit akademik të cilët përbëjnë të paktën $\frac{1}{4}$ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
3. Mbledhja thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim të rendit të ditës, të paktën 7 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes. Së bashku me njoftimin për rendin e ditës, thirrësit e mbledhjes njoftojnë edhe materialet mbi çështjet që do të shqyrtohen në mbledhje. Njoftimi i rendit të ditës dhe i materialeve bëhen me protokoll, në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Neni 14

Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve të senatit akademik

1. Mbledhjet e senatit akademik drejtohen nga Kryetari. Nënkrjetari i senatit akademik drejton mbledhjet e senatit në rast të mungesës së Kryetarit.
2. Mbledhjet e senatit akademik janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se $\frac{2}{3}$ e anëtarëve të senatit akademik. Në rast se në mbledhje janë të pranishëm më pak se $\frac{2}{3}$ e anëtarëve, atëherë mbledhja nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër, por jo më vonë se tetë ditë.
3. Anëtarët e senatit akademik e ushtrojnë vetë funksionin e tyre. Ata nuk mund ta delegojnë votën një anëtar tjetër dhe as të votojnë në emër të një anëtar tjetër të senatit.
4. Votimi në senatin akademik si rregull është i hapur. Në rastet kur vendimi për të cilin do të votohet i referohet personave të përveçëm, senati mund të vendosë me shumicë të thjeshtë për të zhvilluar votim të fshehtë, në rast se kjo kërkohet nga secili prej anëtarëve. Procedurat për zhvillimin e votimit të fshehtë përcaktohen nga senati akademik.
5. Senati merr vendime me shumicë të thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur për marrjen e vendimeve kërkohet një shumicë e cilësuar, sipas përcaktimeve në këtë statut.
6. Vendimet e senatit akademik, si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Senati akademik mund të përcaktojë në vendim kohën e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 15

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjen e senatit akademik

1. Në mbledhjen e senatit akademik, mund të thirren specialist të fushave të ndryshme, që kanë dijeni mbi çështjet të cilat janë shtruar për diskutim. Specialistët mund të jenë të brendshëm apo të jashtëm.
2. Senati akademik, me ndihmën e Rektoratit cakton sekretarinë teknike, si një strukturë *ad hoc*, e cila përbëhet nga të paktën një person për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
3. Pjesë e sekretarisë teknike do të konsiderohen edhe persona të tjerë, punonjës të administratës të cilët japin shpjegime gjatë mbledhjes së Senatit, lidhur me materialet e paraqitura dhe çështjet që diskutohen.

Neni 16

Zbardhja, nënshkrimi dhe publikimi i vendimeve të senatit akademik

1. Vendimet e marra nga senati akademik zbardhen brenda ditës së nesërme të mbledhjes në të cilën vendimi është miratuar.
2. Vendimet e senatit akademik nënshkruhen nga anëtarët që kanë votuar për vendimin. Anëtari i senatit akademik, shënon përbri nënshkrimit edhe fjalët “pro” ose “kundër”, në varësi të mënyrës së votimit
3. Vendimet e senatit akademik publikohen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit. Për sa është e mundur, vendimet e senatit akademik publikohen në faqen e internetit të Akademisë së Arteve.

KREU II

REKTORATI I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 17

Rektorati i Akademisë së Arteve, Përbërja

1. Rektorati i Akademisë së Arteve është organ kolegjal ekzekutiv. Rektorati përbëhet nga:
 - a. Rektori;
 - b. Zëvendësrektorët;
 - c. Dekanët e Fakulteteve
 - d. Kancelari i Akademisë së Arteve.
2. Rektorati thirret në mbledhjen e parë nga Rektori.

Neni 18

Funksionet dhe detyra të tjera të Rektoratit

1. Funksionet e Rektoratit janë si më poshtë:
 - a. harton planin disavjeçar të zhvillimit të Akademisë së Arteve;
 - b. harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik;
 - c. formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - ç. parashtron përparësitë mes kërkesave konkurruese për financime mes Fakulteteve;
 - d. harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në senatin akademik;
 - dh. harton planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, që janë kompetencë e tij;
 - e. paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - ë. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik dhe këshilli i administrimit;
 - f. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të Akademisë së Arteve;

- g. ndjek veprimtarinë në njësitë e Akademisë së Arteve për përmbushjen e qëllimeve të institucionit si dhe për zbatimin e akteve të organeve të Akademisë së Arteve.
2. Rektorati ka edhe detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:
 - a. raporton një herë në semestër në senatin akademik dhe në këshillin e administrimit;
 - b. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit brenda datës 20 dhjetor të çdo viti;
 - c. garanton infrastrukturën dhe shërbimin administrativ për mbarëvajtjen e funksionimit të organeve kolegjiale dhe monokratike të Akademisë;
 - ç. përgatit marrëveshjen ndërmjet Akademisë së Arteve dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për rregullat e financimit;
 - d. mund t'ia delegojë kompetencat personelit apo një organi tjetër të institucionit, në përputhje me rregulloren e tij.
 - dh. propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
 - e. përgatit përshkrimet e punës për pozicionet e punës në Akademinë e Arteve.

Neni 19

Mbledhjet dhe vendimmarrja e Rektoratit

1. Rektorati mbledhet si rregull jo më pak se një herë në dy javë. Në raste të nevojshme Rektorati mund të mbledhet në çdo kohë, me kusht që të lihet kohë e mjaftueshme për shqyrtimin e materialeve që lidhen me çështjet për diskutim.
2. Mbledhja thirret nga Rektori, kryesisht apo me kërkesën e secilit prej anëtarëve të Rektoratit. Mbledhja konsiderohet e vlefshme nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
3. Mbledhja nuk mund të zhvillohet dhe duhet të shtyhet, në rastet kur edhe pse është plotësuar numri i anëtarëve të nevojshëm, nuk është prezent anëtari, i cili ka lidhje të drejtpërdrejta me çështjen për të cilën do të merret vendim.
4. Si rregull Rektorati merr vendime njëzëri. Kur kjo nuk është e mundur vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur nuk mund të arrihet shumica, vota e Rektorit është përcaktuese.
5. Procesverbali i mbajtur në mbledhjen e Rektoratit përbën dokumentin bazë për pasqyrimin e vendimmarrjes.
6. Vendimet e marra nga Rektorati, materializohen në formën e urdhrave të nxjerra nga Rektori i Akademisë së Arteve.

KREU III

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 20

Këshilli i administrimit

1. Këshilli i administrimit është organ kolegjial vendimmarrës, që mbikëqyr e kontrollon veprimtarinë e Akademisë së Arteve, që lidhen me menaxhimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të pronave të saj.
2. Funkcionet e Këshillit të Administrimit të Akademisë së Arteve janë si më poshtë:
 - a. miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare;
 - b. miraton, me kërkesën e senatit akademik, projektbuxhetin e institucionit me dy të tretat e votave;
 - c. vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të ligjshme dhe publikon rezultatet e vlerësimit;

- ç. miraton strukturën dhe numrin e personelit të institucionit për të gjitha nivelet;
- d. miraton raportin vjetor financiar të paraqitur nga rektorati;
- dh. vlerëson planin e zhvillimit të institucionit e programin vjetor të veprimtarive të tij;
- e. miraton rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
- ë. miraton rregulloren e funksionimit të tij.
- f. i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës kriteret për përcaktimin e nivelit të pagave të punonjësve mësimore dhe jo mësimorë, si dhe tarifën e orës mësimore
- g. miraton paraprakisht tarifën e regjistrimit dhe të studimeve në Akademinë e Arteve. Pas miratimit dhe nga senati akademik, tarifa e regjistrimit dhe e shkollimit i propozohet për miratim Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- gj. informon senatin akademik dhe Rektorin për situatën financiare dhe projektet përcaktuese për të gjithë Akademinë e Arteve.

Neni 21

Përbërja e Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i administrimit përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:
 - a. Tre anëtarë të personelit akademik, së paku me gradë shkencore, të zgjedhur drejtpërdrejt nga personeli akademik duke zgjedhur drejtpërdrejt nga 1 anëtarë për secilin Fakultet të Akademisë së Arteve;
 - b. Tre anëtarë të caktuar, përfaqësues nga fushat e shkencës, ekonomisë, kulturës, autoritete të pushtetit qendror dhe vendor;
 - c. një anëtar, përfaqësues i zgjedhur nga këshilli i studentëve të Akademisë së Arteve.
2. Anëtarët, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, caktohen dhe shkarkohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Këshilli i administrimit zgjedh kryetarin, prej anëtarëve të brendshëm të tij, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve.
4. Anëtarësia në këshillin e administrimit është e papajtueshme me detyrën e anëtarit të senatit akademik, të zëvendësrektorit, të dekanit dhe të zëvendësdekanit.

Neni 22

Mandati i Këshillit të Administrimit dhe i anëtarëve të tij

1. Këshilli i Administrimit si organ kolegjial ka mandat 4 vjeçar.
2. Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit fillon nga momenti i zgjedhjes dhe zgjat deri në përfundim të mandatit të Senatit Akademik. Përjashtim nga ky rregull bëjnë anëtarët e Këshillit të Administrimit të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Mandati i anëtarit të Këshillit të Administrimit konsiderohet i përfunduar në mënyrë të parakohshme në rastet kur anëtari:
 - a. Jep dorëheqjen si anëtar i Këshillit të Administrimit;
 - b. Përfundon marrëdhëniet e punës me Akademinë e Arteve apo përfundon/ndërpret studimet në Akademinë e Arteve.
 - c. Vdes;
 - ç. Nuk merr pjesë në më shumë se gjysmën e mbledhjeve të zhvilluara gjatë një viti akademik;
 - d. Dënohet për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
4. Këshilli i Administrimit konstaton vakancën e krijuar me anë të një vendimi deklarativ.
5. Vendi vakant i krijuar nga përfundimi në mënyrë të parakohshme i mandatit të një anëtari të këshillit të administrimit, plotësohet me një person tjetër të zgjedhur nga i njëjti grup i anëtarëve të Akademisë së Arteve.

6. Zgjedhjet për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Administrimit zhvillohen brenda 3 javëve nga data e vendimit për konstatimin e vakancës.

Neni 23

Mbledhja e parë e Këshillit të Administrimit

1. Në mbledhjen e tij të parë, Këshilli i administrimit thirret nga Rektori i Akademisë së Arteve.
2. Në këtë mbledhje zgjidhet kryetari i Këshillit të Administrimit, nga radhët e anëtarëve të brendshëm, me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit.
3. Zgjedhja e kryetarit bëhet edhe në rastet e mbarimit të mandatit në mënyrë të parakohshme të anëtarit të zgjedhur kryetar, apo kur kryetari jep dorëheqjen nga kjo detyrë.
4. Nënkryetari propozohet nga Kryetari i senatit akademik dhe zgjidhet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të senatit akademik.

Neni 24

Thirrja e mbledhjes së Këshillit të Administrimit

1. Këshilli i administrimit si rregull mblidhet të paktën një herë në muaj.
2. Mbledhja e Senatit akademik thirret nga kryetari i këshillit të administrimit apo dy anëtarë të tij. Mbledhja mund të thirret edhe me kërkesë të Rektorit të Akademisë së Arteve.
3. Mbledhja thirret nëpërmjet njoftimit me shkrim të rendit të ditës, të paktën 7 ditë përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e mbledhjes. Së bashku me njoftimin për rendin e ditës, thirrësit e mbledhjes njoftojnë edhe materialet mbi çështjet që do të shqyrtohen në mbledhje. Përgatitja dhe njoftimi i rendit të ditës dhe i materialeve bëhen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit.

Neni 25

Vlefshmëria e mbledhjes dhe e vendimeve të Këshillit të Administrimit

1. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit drejtohen nga Kryetari.
2. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve të Këshillit të Administrimit. Në rast se në mbledhje janë të pranishëm më pak se gjysma e anëtarëve, atëherë mbledhja nuk zhvillohet dhe shtyhet për një datë tjetër, por jo më vonë se tre ditë.
3. Anëtarët e Këshillit të Administrimit e ushtrojnë vetë funksionin e tyre. Ata nuk mund ta delegojnë votën një anëtar tjetër dhe as të votojnë në emër të një anëtar tjetër.
4. Votimi në Këshillin e Administrimit është i hapur.
5. Këshilli i administrimit merr vendime me shumicë të thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur për marrjen e vendimeve kërkohet një shumicë e cilësuar, sipas përcaktimeve në këtë statut.
6. Vendimet e Këshillit të Administrimit, si rregull hyjnë në fuqi menjëherë. Këshilli i Administrimit mund të përcaktojë në vendim kohën e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 26

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhjen e Këshillit të Administrimit

1. Rektori dhe kancelari i institucionit kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të administrimit, pa të drejtë vote, kur e vlerësojnë ata vetë, si dhe kur thirren nga ky këshill.

2. Në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, mund të thirren specialist të fushave të ndryshme, që kanë dijeni mbi çështjet të cilat janë shtruar për diskutim. Specialistët mund të jenë të brendshëm apo të jashtëm.
3. Kancelari i Akademisë së Arteve kryeson sekretarinë teknike që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Administrimit. Kancelari cakton një person për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.
4. Pjesë e sekretarisë teknike do të konsiderohen edhe persona të tjerë, punonjës të administratës të cilët japin shpjegime gjatë mbledhjes, lidhur me materialet e paraqitura dhe çështjet që diskutohen.

Neni 27

Zbardhja, nënshkrimi dhe publikimi i vendimeve të Këshillit të Administrimit

1. Vendimet e Këshillit të Administrimit zbardhen brenda ditës së nesërme të mbledhjes në të cilën vendimi është miratuar.
2. Vendimet nënshkruhen nga anëtarët që kanë votuar për vendimin. Anëtari i Këshillit të Administrimit, shënon përbri nënshkrimit edhe fjalët "pro" ose "kundër", në varësi të mënyrës së votimit
3. Vendimet publikohen në përputhje me rregullat e brendshme të përcaktuara për qarkullimin dhe administrimin e dokumentacionit. Për sa është e mundur, vendimet e Këshillit të Administrimit publikohen në faqen e internetit të Akademisë së Arteve.

KREU IV

KËSHILLI I ETIKËS NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 28

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i etikës në Akademinë e Arteve ngrihet me Vendim të Senatit Akademik. Ky këshill ka një mandat 4 vjeçar. Këshilli i etikës përbëhet nga 4 anëtarë, të përzgjedhur nga punonjësit akademik të Akademisë së Arteve.
2. Këshilli i Etikës ka si funksion kryesor diskutimin e problemeve që lidhen me etikën e jetës universitare në Akademinë e Arteve.
3. Këshilli i etikës merr vendime dhe i paraqet propozime Rektorit të Akademisë së Arteve.

Neni 29

Funksionimi i Këshillit të Etikës

1. Senati akademik cakton Kryetarin e Këshillit të Etikës.
2. Këshilli i Etikës mblidhet sa herë që paraqitet një kërkesë për shqyrtim nga subjektet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.
3. Kërkesa që paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Etikës përmban të paktën të dhënat e kërkuarit, një përshkrim të shkurtër të çështjes së shtruar për diskutim, si edhe materiale shoqëruese të cilat shërbejnë për shqyrtimin e çështjes.
4. Këshilli i Etikës merr në shqyrtim kërkesa të paraqitura nga:
 - a. Rektori;
 - b. Zëvendësrektori;
 - c. Senati Akademik;
 - ç. Këshilli i Administrimit;
 - d. Dekani;
 - dh. Këshilli i Fakultetit
 - e. Këshilli i Profesorëve;

- ë. Këshilli i Studentëve;
- f. Të paktën 2 anëtarë të personelit akademik të Akademisë së Arteve.

Neni 30
Kodi i Etikës

1. Kodi i etikës diskutohet nga Këshilli i Etikës dhe më pas i kalon për miratim Senatit akademik.
2. Kodi i etikës përfshin edhe rregulla më të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës.

KREU V
KËSHILLI I FAKULTETIT

Neni 31
Këshilli i Fakultetit

1. Këshilli i fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës në kuadër të Fakultetit përkatës.
2. Këshilli i Fakultetit ka këto funksione:
 - a. programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit;
 - b. propozon programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor;
 - c. propozon hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësisht të tjera;
 - ç. merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij;
 - d. shqyrton e miraton, në një mbledhje të hapur për personelin akademik administrativ dhe për studentët, raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore, kërkimore dhe financiare të fakultetit
 - dh. i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.
3. Këshilli i fakultetit kryesohet nga Dekani.

Neni 32
Kompetencat e Këshillit të Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit ushtron edhe kompetencat e mëposhtme:
 - a. Miraton rregulloren e fakultetit dhe njësive të reja që ngre.
 - b. I propozon Rektorit strukturën dhe numrin e punonjësve në fakultet.
 - c. Miraton në parim marrëveshjet që synon të lidhë fakulteti me të tretë para se ato të nënshkruhen.
 - ç. Propozon, në bashkëpunim me Bibliotekën e Akademisë së Arteve, listën e periodikëve artistike shkencore si dhe titujt e librave ku do të pajtohet apo do të blejë fakulteti.
 - d. Miraton mënyrën e përdorimit të dhurimeve që janë kryer në favor të fakultetit apo njësive të tjera ndihmëse në përbërje të fakultetit.
 - dh. Miraton ngritjen e komisioneve apo grupeve të ndryshme për të ndjekur probleme të ndryshme të procesit mësimor dhe artistik në fakultet.
2. Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij Këshilli i Fakultetit shprehet me vendim.

Neni 33
Përbërja e Këshillit të Fakultetit dhe zgjedhja e anëtarëve

1. Këshilli i Fakultetit në Akademinë e Arteve përbëhet nga 9 anëtarë.

2. Ndarja e anëtarëve në Këshillin e Fakultetit bëhet e tillë që raportet mes anëtarëve të zgjedhur nga grupet e ndryshme brenda fakultetit të jenë si më poshtë:
 - a. 80% e anëtarëve janë personel akademik i fakultetit;
 - b. 15% e anëtarëve janë studentë të fakultetit;
 - c. 5% e anëtarëve janë personel jo akademik i fakultetit.
3. Anëtarët e këshillit të fakultetit zgjidhen drejtpërdrejt nga grupet përkatëse të anëtarëve të fakultetit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve në Akademinë e Arteve.

Neni 34

Mbledhjet dhe vendimmarrja e Këshillit të Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit thirret në mbledhje nga Dekani, apo të paktën dy anëtarë të tij.
2. Thirrja e mbledhjes bëhet duke njoftuar, të paktën 3 ditë para, rendin e ditës dhe materialet e mbledhjes.
3. Mbledhja e këshillit të fakultetit quhet e vlefshme në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit. Në rast të mos formimit të shumicës së nevojshme, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më shumë se dy ditë pune.
4. Votimi në mbledhjen e këshillit të fakultetit, në çdo rast është i hapur.
5. Vendimet e këshillit të fakultetit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

KREU VI

KËSHILLI I PROFESORËVE NË FAKULTET

Neni 35

Këshilli i Profesorëve

1. Për organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës, në fakultetet e Akademisë së Arteve, të cilat ofrojnë programe studimi të ciklit të tretë, ngrihet këshilli i profesorëve.
2. Ky këshill përbëhet nga të gjithë profesorët e fakultetit me kohë të plotë. Numri minimal i tyre duhet të jetë shtatë persona.
3. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në Këshillin e Profesorëve mund të thirren profesorë të fushave të afërta, nga fakultete të tjera brenda Akademisë së Arteve, profesorë të ftuar apo profesorë me kontratë të fakultetit, ose anëtarë me titullin “Profesor i Asociuar”, të cilët janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”.

Neni 36

Detyrat dhe funksionimi i Këshillit të Profesorëve

1. Këshilli i profesorëve të fakultetit kryen këto detyra:
 - a. Kryen procedurat për vlerësimin e kandidatëve për marrjen e titullit “Docent” dhe bën propozimet përkatëse dekanit të fakultetit;
 - b. Shqyrton dhe vlerëson kërkesat për dhënien e titullit “Profesor i Asociuar”, nga personeli akademik i Akademisë së Arteve, apo nëse është rasti nga personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë që nuk kanë të drejtën e promovimit të personelit akademik;
 - c. Shqyrton dhe vlerëson kërkesat për dhënien e titullit “Profesor”, nga personeli akademik i Akademisë së Arteve, apo nëse është rasti nga personeli akademik i institucioneve të arsimit të lartë që nuk kanë të drejtën e promovimit të personelit akademik.

- ç. Kryen vlerësimin dhe njësimin e titujve akademik të fituar jashtë shtetit, të barasvlershëm me titullin akademik “Prof. Asoc.”.
 - d. Miraton personelin akademik të ftuar, që do të mbulojë realizimin e disiplinave teorike të studimeve të doktoratës, si dhe udhëheqjen e disertantëve, sipas titullit apo gradës shkencore, dhe numrit përkatës të studentëve, për çdo udhëheqës.
 - dh. Shqyrton dhe vlerëson dosjet e paraqitura nga studentët që ndjekin studimet e doktoraturës, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.
 - e. Ngre komisionet ad-hoc për drejtimin e konkurrimit të hapur për përzgjedhjen e titullarëve të grupeve mësimore apo mësimore e kërkimore.
2. Këshilli i Profesorëve mbledhet si rregull një herë në tre muaj. Një profesor e drejton Këshillin e Profesorëve, me rotacion, për një vit akademik. Mbledhja, si rregull thirret nga Kryetari i Këshillit të Profesorëve. Mbledhja mund të thirret gjithashtu nga Dekani, apo nga çdo anëtar i Këshillit të Profesorëve.
 - 2.1. Kryetari i Këshillit të Profesorëve zgjidhet si rregull me votim të hapur, nga vetë anëtarët e KP. Mbledhja e KP për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Profesorëve thirret jo më vonë se 15 ditë nga fillimi i vitit të ri akademik.
 3. Çështjet në Këshillin e Profesorëve shqyrtohen në mbledhje kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Nëse nuk plotësohet kuorumi mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më shumë se 5 ditë. Thirrësi i mbledhjes realizon njoftimin e mbledhjes zyrtarisht. Një çështje quhet e miratuar nga Këshilli i Profesorëve nëse shumica e pjesëmarrësve votojnë pro, në të kundërt çështja quhet e rrëzuar.
 4. Komisionet ad-hoc sipas pikës 1 germa e të këtij neni, ngrihen nga KP, duke caktuar tre anëtarë të Këshillit, të cilët bëjnë vlerësimin në përputhje me kriteret e përcaktuara për konkurrim. Komisioni ad-hoc vendos me shumicë votash mbi klasifikimin e kandidaturave dhe ia paraqet këtë klasifikim Këshillit të Profesorëve.

PJESA E TRETË

AUTORITETET DREJTUESE NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 37

Autoritetet drejtuese

1. Autoritetet drejtuese në Akademinë e Arteve janë:
 - a. Rektori;
 - b. Dekani;
 - c. Përgjegjësi i departamentit.
2. Kriteret për autoritetet drejtuese, detyrat dhe të drejtat e këtyre autoriteteve, që burojnë nga ligji, përcaktohen në këtë statut dhe rregulloret e Akademisë së Arteve.

KREU I

REKTORI I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 38

Rektori

1. Rektori është autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
2. Rektori i Akademisë së Arteve duhet të kenë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

Neni 39

Funksionet dhe kompetencat e Rektorit të Akademisë së Arteve

1. Rektori i Akademisë së Arteve ka këto funksione:
 - a. Drejton dhe përfaqëson Akademinë e Arteve në marrëdhënie me të tretët;
 - b. Është anëtar i Konferencës së Rektorëve;
 - c. Është Kryetar i Senatit;
 - ç. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese të fakulteteve.
 - d. Lëshon diploma për përfundimin e programeve të studimit, që janë organizuar në Akademinë e Arteve
2. Rektori i Akademisë së Arteve ushtron edhe këto kompetenca:
 - a. Propozon emrin/at e Zëvendësrektorit/ëve për miratim në senatin akademik dhe i emëron ata pas miratimit ;
 - b. Emëron Dekanët e zgjedhur të Fakulteteve;
 - c. Vendos për hyrjen e Akademisë së Arteve në lidhje me shkolla të larta të vendit dhe të huaja, shoqata e organizata të ndryshme, për shkëmbim përvoja dhe bashkëpunim me procesin mësimor-shkencor e artistik, si dhe për kualifikimin e punonjësve mësimore;
 - ç. I përcjell Ministrin të Arsimit dhe Shkencës kandidaturën për Kancelar të përzgjedhur nga Këshilli i Administrimit
 - d. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një autoritet drejtues i një njësie kryesore, rektori urdhëron pezullimin e atij autoriteti dhe i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri, sipas këtij ligji. Rektori organizon zgjedhjet e parakohshme.
 - dh. Miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit shkollor;
 - e. Miraton punonjësit mësimorë shkencorë të cilët për vitin shkollor do të jenë nën ngarkesën vjetore të normës mësimore, duke përcaktuar për çdo rast këtë ngarkesë.
 - ë. Emëron punonjësit mësimorë e shkencorë, drejtuesit e strukturave të administratës si dhe specialistët e lartë, duke iu përmbajtur kritereve për zënieën e këtyre vendeve, sipas përcaktimeve të njërive përkatëse si dhe nënshkruan kontratat e punës së punonjësve të emërtesës së tij, sipas përcaktimeve të njërive përkatëse, si dhe i shkarkon ata në rastet e parashikuara me ligj dhe në përputhje me këtë Statut dhe akte të tjera;
 - f. Ngre komisione të cilëve ju ngarkon detyra të veçanta.
 - g. Nxjerr urdhra të brendshëm për veprimtarinë e përditshme të administratës së Akademisë së Arteve, vendos masa disiplinore dhe administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut.
 - gj. Deleton firmën nëpunësve të tjerë në vartësi të tij, për kryerjen e detyrave të caktuara, kur e çmon të arsyeshme.
 - h. Vendos përjashtimin nga shkolla e lartë të studentëve për rastet e parashikuara në rregulloren përkatëse të studentëve
 - i. Jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Akademisë së Arteve dhe mund t'u bëjë apel këtyre forcave në rast nevojë.
3. Rektori i Akademisë së Arteve kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Akademisë së Arteve apo akte të tjera.

Neni 40

Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Rektorit

1. Rektori i Akademisë së Arteve zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik,

personeli jo akademik dhe studentët e institucionit, në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve në Akademinë e Arteve.

2. Për postin e Rektorit mund të konkurrojnë individë të personelit akademik të Akademisë së Arteve ose individë jashtë tij. Këta të fundit, në rastin kur rezultojnë fitues, bëhen anëtarë të personelit akademik të institucionit.
3. Në zgjedhjen e Rektorit të Akademisë së Arteve, votat e studentëve dhe votat e personelit jo akademik përlogariten me përqindje, ato vlejnë 20 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për studentët dhe 5 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për personelin jo akademik.
4. Rektori i Akademisë së Arteve zgjidhet për një mandat 4 vjeçar.
5. Rektori i Akademisë së arteve emërohet me dekret të Presidentit të Republikës
6. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga rektori, Ministri i Arsimit dhe Shkencës urdhëron pezullimin e tij, duke ia dërguar atë për procedura të mëtejshme Presidentit të Republikës, i cili duhet të përgjigjet brenda një muaji. Ministri i Arsimit dhe Shkencës cakton njërin prej zëvendësrektorëve që do të zëvendësojë rektorin e pezulluar, deri në zgjedhjen e rektorit të ri. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, menjëherë pas dekretimit të shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme.

Neni 41

Përfundimi i mandatit të Rektorit të Akademisë së Arteve

1. Mandati i Rektorit të Akademisë së Arteve përfundon me përfundimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i Rektorit mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Kur ndërron jetë;
 - c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrisë funksionin;
 - ç. Kur dekretohet shkarkimi i tij;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
3. Në rastet e përcaktuara nga ky nen, shpallen zgjedhje të parakohshme për zgjedhjen e Rektorit.

KREU II

DEKANI I FAKULTETIT NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 42

Dekani

1. Dekani është autoriteti drejtues në një Fakultet të Akademisë së Arteve, i cili e përfaqëson atë dhe vepron në emër dhe për llogari të tij.
2. Dekani duhet të kenë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

Neni 43

Funksionet dhe kompetencat e Dekanit

1. Dekani ka këto funksione:
 - a. Drejton dhe përfaqëson Fakultetin;
 - b. Është Anëtar i Senatit;
 - c. Drejton Këshillin e Fakultetit;
 - ç. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë mbi autoritetet drejtuese brenda fakultetit.
2. Dekani ushtron edhe këto kompetenca:

- a. Propozon emrin e Zëvendësdekanit për miratim në këshillin e fakultetit dhe e emëron atë pas miratimit;
 - b. Emëron përgjegjësën e zgjedhur të departamentit;
 - c. Emëron përgjegjësitet e grupeve mësimore mbi bazën e propozimit të titullarit të njësisë bazë.
 - ç. Drejton e kontrollon gjithë punën mësimore-edukuese e shkencore-artistike në fakultet për përgatitjen e specialistëve të lartë.
 - d. Organizon konkurset e pranimeve të studentëve të rinj në fakultet dhe kontrollon mirëfunksionimin e komisioneve të pranimeve.
 - dh. Miraton rregulloret e brendshme të njësisë në përbërje të fakultetit.
 - e. Në bazë të numrit të studentëve dhe të angazhimeve të fakultetit i propozon Rektorit hapjen e vendit për zëvendësdekan në atë fakultet.
 - ë. Miraton kryetarët e anëtarët e komisioneve të provimeve të pranimeve, të provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomave, tezat e provimeve të pranimit, të provimeve të formimit dhe temat e projekt – diplomave, me propozim të Përgjegjësitet të Njësisë Bazë.
 - f. Shpall rezultatet e konkurseve të pranimit.
 - g. Dekani në ushtrim të kompetencave, shprehet me urdhra dhe udhëzime.
 - gj. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga përgjegjësi i një departamenti i propozon rektorit shkarkimin e tij. Rektori shprehet brenda një muaji. Dekani cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve kërkimore ose shkencore që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Dekani organizon zgjedhjet e parakohshme.
3. Dekani kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Akademisë së Arteve apo akte të tjera.

Neni 44

Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Dekanit

1. Dekani zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik, personeli jo akademik dhe studentët e Fakultetit përkatës, në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve në Akademinë e Arteve.
2. Për postin e Dekanit mund të konkurrojnë individë të personelit akademik të fakultetit përkatës ose individë jashtë tij. Këta të fundit, në rastin kur rezultojnë fitues, bëhen anëtarë të personelit akademik të fakultetit përkatës.
3. Në zgjedhjen e Dekanit, votat e studentëve dhe votat e personelit jo akademik përlogariten me përqindje, ato vlejnë 20 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për studentët dhe 5 për qind në totalin e përgjithshëm të votave për personelin jo akademik.
4. Dekani i Fakultetit zgjidhet për një mandat 4 vjeçar. Dekani i Fakultetit emërohet nga Rektori i Akademisë së Arteve.
5. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga një Dekan, rektori urdhëron pezullimin e tij dhe i propozon Ministrin të Arsimit dhe Shkencës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji. Rektori cakton njërin prej zëvendësdekanëve që do ta zëvendësojë dekanin e pezulluar deri në zgjedhjen e dekanit të ri. Rektori organizon zgjedhjet e parakohshme.

Neni 45

Përfundimi i mandatit të dekanit të Fakultetit

1. Mandati i Dekanit përfundon me përfundimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i Dekanit mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Kur ndërron jetë;

- c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrijë funksionin;
 - ç. Kur vendoset shkarkimi i tij;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
3. Në rastet e përcaktuara nga ky nen, shpallen zgjedhje të parakohshme për zgjedhjen e dekanit.

KREU III
PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT NË FAKULTETET E AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 46
Përgjegjësi i Departamentit

1. Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues në një Departament të një prej Fakulteteve të Akademisë së Arteve.
2. Përgjegjësi i Departamentit duhet të kenë të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe me përvojë akademike në këto universitete.

Neni 47
Funksionet dhe kompetencat e përgjegjësit të departamentit

Përgjegjësi i Departamentit ka këto funksione dhe kompetenca:

- a. Drejton dhe përfaqëson departamentin;
- b. Drejton e kontrollon gjithë punën mësimore-edukuese e shkencore-artistike në departament.
- c. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në Statutin e Akademisë së Arteve apo akte të tjera.

Neni 48
Zgjedhja, mandati, emërimi dhe shkarkimi i Përgjegjësit të Departamentit

1. Përgjegjësi i Departamentit zgjidhet me votim të fshehtë nga i gjithë personeli akademik që përfshihet në departamentin përkatës, në përputhje me dispozitat e këtij statuti dhe sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zgjedhjeve në Akademinë e Arteve.
2. Përgjegjësi i Departamentit zgjidhet për një mandat 4 vjeçar.
3. Përgjegjësi i Departamentit emërohet nga dekani i fakultetit përkatës.
4. Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga përgjegjësi i një departamenti i propozon rektorit shkarkimin e tij. Rektori shprehet brenda një muaji. Dekani cakton njërin prej përgjegjësve të grupeve kërkimore ose shkencore që do ta zëvendësojë autoritetin drejtues të pezulluar deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Dekani organizon zgjedhjet e parakohshme.

Neni 49
Përfundimi i mandatit të përgjegjësit të departamentit

1. Mandati i përgjegjësit të departamentit përfundon me mbarimin e periudhës për të cilën është zgjedhur.
2. Mandati i përgjegjësit të departamentit mund të përfundojë në mënyrë të parakohshme kur ai:
 - a. Jep dorëheqjen;
 - b. Kur ndërron jetë;
 - c. Bëhet e pamundur nga ana fizike ose mendore të ushtrijë funksionin;
 - ç. Kur vendoset shkarkimi i tij;
 - d. Kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

3. Në rastet e përcaktuara nga ky nen, shpallen zgjedhje të parakohshme për zgjedhjen e përgjegjësit të ri të departamentit.

PJESA E KATËRT

AUTORITETET TË TJERA NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 50 Autoritetet e tjera

1. Autoritete të tjera në Akademinë e Arteve janë:
 - a. Kancelari i Akademisë së Arteve;
 - b. Zëvendësrektori/ët;
 - c. Zëvendësdekani/ët;
2. Autoritet e tjera emërohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut.

KREU I KANCELARI I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 51 Kancelari

1. Kancelari i Akademisë së Arteve është autoritet, në përbërje të Rektoratit.
2. Kancelari, për përmbushjen e funksionit, kryen detyrat e mëposhtme:
 - a. Drejton veprimtarinë e administratës;
 - b. Realizon administrimin financiar;
 - c. Drejton planifikimin dhe realizimin e investimeve;
 - ç. Mbikëqyr të gjitha procedurat e marrjes në punë;
 - d. Drejton procedurat e marrjes në punë dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të administratës;
 - dh. Me autorizimin e rektorit, përfaqëson ose bashkëpërfaqëson institucionin në të gjitha proceset gjyqësore apo zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me palët e treta, persona, fizikë ose juridikë;
 - e. Kryeson sekretariatit teknik, që mbështet veprimtarinë e këshillit të administrimit të institucionit (më poshtë KADM);
 - ë. Mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e institucionit;
 - f. Është anëtar i Rektoratit.
3. Kancelari ushtron edhe kompetencat e mëposhtme:
 - a. Paraqet aktet me natyrë ekonomike dhe financiare për miratim në këshillin e administrimit dhe për mendim paraprak në senatin akademik kur është e nevojshme.
 - b. Propozon hartimin e studimeve për zhvillimin perspektiv të Akademisë së Arteve.
 - c. Propozon strukturat dhe numrin e personelit për rektoratin dhe fakultetet, pasi ka marrë propozimin e këshillave të tyre.
 - ç. Organizon kryerjen e kontroll-revizionit financiar të Akademisë së Arteve
 - d. Përfaqëson Akademinë e Arteve si firmë e parë e deleguar nga Rektori në marrëdhëniet financiare me Bankën e Shtetit Shqiptar dhe në marrëdhënie kontraktore me të tretët.
 - dh. Thërret në raport administratorët e fakulteteve.
 - e. Drejton procedurat e vlerësimit të punës së punonjësve të administratës;
 - ë. I propozon Rektorit marrjen e masave disiplinore-administrative ndaj nëpunësve të vartësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Kancelari kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut apo në akte

të tjera, por nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ, në institucionin e arsimit të lartë.

Neni 52

Emërimi dhe shkarkimi i Kancelarit të Akademisë së Arteve

1. Për përzgjedhjen dhe emërimin e kancelarit të institucionit ndiqen procedurat e mëposhtme:
 - a. Këshilli i Administrimit miraton kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët;
 - b. Akademia e Arteve shpall publikisht, për dy javë kalendarike, vendin e punës dhe kriteret, që duhet të plotësojnë kandidatët për kancelar, si dhe shpall fillimin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse janë paraqitur, së paku, tri kandidatura.
 - c. Këshilli i Administrimit harton skemën e vlerësimit të kandidatëve duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të legjislacionin për nëpunësit civil. Përveç vlerësimit të dosjes mund të parashikohet edhe një intervistë;
 - ç. Çdo anëtar i Këshillit të Administrimit bën vlerësimin, me shkrim, sipas skemës së miratuar, për çdo kandidat, dhe në fund, në bazë të pikëve të grumbulluara, shpallet renditja e kandidatëve;
 - d. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të përzgjedhë, me votim të fshehtë, njërin nga tri kandidatët, që kanë grumbulluar më shumë pikë. Fitues shpallet kandidati, që merr 2/3 e votave të anëtarëve.
 - dh. Këshilli i Administrimit, pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve, shpall publikisht kandidaturën fituese. Kandidatët kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e Këshillit të Administrimit, vetëm për procedurën e vendimmarrjes, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes. Ankesat depozitohen në protokollin e Akademisë së Arteve. Këshilli i Administrimit ka të drejtë të shqyrtojë ankesat, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, dhe u përgjigjet atyre me shkrim.
 - e. Këshilli i Administrimit pas rishqyrtimit ia dërgon propozimin e vet Rektorit të Akademisë së Arteve, brenda 2 ditëve pune.
 - ë. Rektori, pas përfundimit të procesit të ankimimit, ia përcjell Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dosjen e kandidatit për kancelar, brenda 2 ditëve pune nga data e ardhjes së propozimit, së bashku me vendimin e me relacionin shoqërues të Këshillit të Administrimit, ku pasqyrohet i plotë edhe qëndrimi i pakicës, që ka votuar kundër. Kur rektori nuk ia dërgon ministrit propozimin e Këshillit të Administrimit për kandidaturën për kancelar brenda afatit të mësipërm, kryetari i këtij këshilli i dërgon ministrit vendimin, brenda 2 ditëve pune.
 - f. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të pranojë ose refuzojë kandidaturën e propozuar, brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së propozimit. Në rast refuzimi të kandidaturës, përsëritet e gjithë procedura e përzgjedhjes së kancelarit të institucionit. Në rast se ministri refuzon edhe kandidaturën e propozuar herën e dytë, ai ka të drejtë të emërojë një kancelar të komanduar, për jo më shumë se 1 vit. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli i Administrimit përzgjedh një kandidaturë të re, sipas procedurave të mësipërme.
2. Kancelari shkarkohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me nismën e vet, me propozimin e Këshillit të Administrimit ose të Rektorit të Akademisë së arteve. Procedurat, që ndiqen nga Këshilli i Administrimit, për shkarkimin e kancelarit e për mënyrën e votimit, janë të njëjta me ato të ndjekura për përzgjedhjen e tij.

Neni 53

Kriteret për Kancelar

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati që do të emërohet kancelar janë:

- a. Të ketë kryer arsimin e lartë juridik apo ekonomik;
 - b. Të ketë së paku pesë vite pune eksperiencë në institucione shtetërore apo private në këto specialitete;
 - c. Të paraqesë një platformë për administrimin ekonomik-financiar të Akademisë së Arteve.
2. Këshilli i Administrimit përcakton kritere të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, ketë Statut dhe akte të tjera.

KREU II ZËVENDËSREKTORI DHE ZËVENDËSDEKANI I AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 54 Numri dhe detyrat e Zëvendësrektorëve

1. Akademia e Arteve ka dy zëvendësrektorë.
2. Zëvendësrektori ushtron këto detyra:
 - a. Zëvendëson Rektoren në raste të mungesës së tij me autorizimin e këtij të fundit;
 - b. Organizon dhe kontrollon punën mësimore-formuese-shkencore në gjithë Akademinë e Arteve;
 - c. Ndjek hartimin dhe zbatimin e planeve e të programeve mësimore në fakultete dhe në departamente;
 - ç. Ndjek dhe kontrollon ecurinë e zhvillimit të punës shkencore në Akademinë e Arteve;
 - d. Organizon dhe kontrollon punën për specializimin afatgjatë, brenda dhe jashtë vendit, të personelit mësimor shkencor të Akademisë së Arteve;
 - dh. Harton projekt-planin kalendarik të procesit mësimor në shkallë akademike dhe ia paraqet rektorit për miratim;
 - e. Kontrollon organizimin dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit të studentëve të rinj;
 - ë. Kontrollon dhe përgjithëson përvojën e fakulteteve dhe të njësive më të vogla mësimore të Akademisë së Arteve në procesin mësimor-edukativ;
 - f. Ndjek bashkëpunimin shkencor të njësive të Akademisë së Arteve me institucione shkencore e artistike, shkolla të tjera të larta, firma, ndërmarrje prodhimi, etj.;
 - g. Ka në vartësi direkte Degën Mësimore dhe Specialistin për punën shkencore;
 - gj. Organizon kryerjen e studimeve për zhvillimin perspektiv të Akademisë së Arteve në fushat që mbulon dhe ia paraqet Rektorit;
 - h. I paraqet Rektorit projektet e mundshme lidhur me punën shkencore;
 - i. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut apo akte të tjera.
3. Detyrat për secilin prej zëvendësrektorëve përcaktohen në aktin e emërimit nga Rektori.
4. Rektori i Akademisë së Arteve ka të drejtë t'i propozojë senatit akademik ndryshimin e numrit të zëvendësrektorëve, duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse.

Neni 55 Përzgjedhja, miratimi, emërimi dhe shkarkimi i Zëvendësrektorit

1. Zëvendësrektorët në Akademinë e Arteve përzgjidhen nga personel akademik i Akademisë së Arteve dhe kanë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, ose kanë gradën shkencore “Doktor”.
2. Rektori i Akademisë së Arteve propozon kandidaturën e përzgjedhur prej tij në senatin akademik.
3. Senatit Akademik miraton propozimin e paraqitur nga Rektori, në mbledhjen e tij të parë. Rektori i Akademisë së Arteve emëron Zëvendësrektorin e miratuar nga senati akademik.
4. Zëvendësrektori i Akademisë së Arteve shkarkohet nga Rektori, duke ndjekur të njëjtat procedura për emërimin e tij.

5. Zëvendësrektori largohet nga detyra kur:
 - a. Kur jep dorëheqjen;
 - b. Kur shkarkohet nga Rektori për shkelje të akteve ligjore e nënligjore apo me veprimet e tij, cenon veprimtarinë e Akademisë së Arteve;
 - c. Kur për arsye fizike apo mendore konstatohet pamundësia në kryerjen e detyrave të ngarkuara.
 - ç. Kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
6. Në rast shkarkimi të zëvendësrektorit, Rektori, brenda 10 ditëve, i propozon senatit akademik emrin e zëvendësrektorit të ri.

Neni 56

Zëvendësdekani në Akademinë e Arteve

1. Zëvendësdekani emërohet dhe shkarkohet nga dekani pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në këshillin e fakultetit.
2. Zëvendësdekani duhet të jetë lektor i një lënde dhe në marrëdhënie pune në fakultetin përkatës, si dhe të ketë kryer të paktën studimet në nivelin "Master".
3. Zëvendësdekani ushtron kompetenca të përcaktuara në aktin e emërimit.
4. Zëvendësdekani zëvendëson Dekanin, në rastet kur ky mungon, ose në raste të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Dekani mund të përcaktojë grupin e detyrave që mund të ushtrojë zëvendësdekani, me delegim, sipas pikës 3 të këtij neni.
6. Dispozita të tjera lidhur me zëvendësdekanin mund të përcaktohen në Rregulloren e Fakultetit.

PJESA E PESTË

ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË AKADEMINË E ARTEVE

KREU I

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 57

Format e studimit në Akademinë e Arteve

1. Forma e studimeve në Akademinë e Arteve është studime me kohë të plotë. Forma të tjera studimi mund të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Aplikimi dhe zbatimi i formave të studimit, bëhet me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 58

Programet e studimeve

1. Programet e studimeve në Akademinë e Arteve organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.
2. Akademia e Arteve ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
3. Në Akademinë e Arteve, programet e studimeve hartohen nga departamentet. Këshillat e fakulteteve pasi japin miratimin e tyre, ia propozojnë për miratim senatit akademik.
4. Rektorati ka përgjegjësinë që programet e akredituara të studimeve që ofron Akademia e Arteve, të shpallen publikisht para fillimit të aplikimeve për pranime në to.

5. Programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, janë programe të studimeve universitare
6. Akademia e Arteve ka të drejtë të ofrojë edhe programe të studimeve jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve është jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet "Diplomë profesionale" në fushën e arsimit të kryer. Kreditet e akumuluar gjatë studimeve pas arsimit të mesëm mund të transferohen në studimet universitare të ciklit të parë, në përputhje me kriteret që vendosë Senati Akademik.

Neni 59

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Akademinë e Arteve zhvillohen me bazë vitin akademik. Shpallja e datës së fillimit të vitit akademik bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Viti akademik organizohet në semestra me së paku 20 orë mësimi leksione, seminare e laboratorë në javë.

Neni 60

Tarifat e studimeve

1. Tarifat e studimeve përfshijnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit. Tarifat e studimeve janë të diferencuara sipas cikleve apo formave të studimeve.
2. Tarifat e regjistrimit për të gjitha programet e studimeve propozohen nga Akademia e Arteve dhe miratohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.
3. Tarifa e shkollimit për ciklin e parë për sistemin e studimeve me kohë të plotë në ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve vendoset nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kjo e fundit merr edhe mendimin e Konferencës së Rektorëve dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.
4. Tarifa e shkollimit në çdo rast nuk mund të kalojë vlerën e kostos së studimeve.

KREU II

STUDIMET NË CIKLIN E PARË

Neni 61

Programet e ciklit të parë të studimeve

1. programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh;
2. programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;
3. në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut.

Neni 62

Pranimi në ciklin e parë të studimeve

1. Çdo person që ka mbaruar maturën shtetërore ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar të ndjekë studimet në Akademinë e Arteve.
2. Studimet në Akademinë e Arteve mund t'i ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe dhe legjislacionin në fuqi.

3. Studimet në Akademinë e Arteve mund të ndjekin edhe shtetas shqiptare e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta (degë e dytë) kundrejt pagimit të tarifës së caktuar.
4. Akademia e Arteve ka të drejtë të propozojë kritere të veçanta të konkurseve të pranimit për çdo specialitet, të cilat miratohen nga Ministri që mbulon fushën e arsimit. Këto kritere dhe rregulloret e konkurseve bëhen publike nga Akademia e Arteve, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi Fakultetin përkatës dhe programet që ofron.

Neni 63

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të parë

1. Programet e studimeve të ciklit të parë duhet të përmbajnë elementet e mëposhtme:
 - a. të dhëna të përgjithshme për programin, formën dhe objektivat kryesorë, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;
 - b. klasifikimin e programit të studimit, që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit kombëtar të kualifikimeve;
 - c. kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastet e pranimeve me numër të kufizuar;
 - ç. metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
 - d. kushtet për transferime ndërmjet programeve dhe kushtet për përfundimin e pjesshëm të programit, nëse ai e parashikon këtë gjë;dh. titujt akademik dhe profesionalë, që akordohen sipas ligjit.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit mund të përcaktohen nga Senati akademik.

Neni 64

Lëshimi i diplomave dhe dokumenteve të tjera

1. Akademia e Arteve pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
2. Diplomat për ciklin e parë shoqërohen me suplementin e diplomës.
3. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen, rezultatet e studimeve, që janë kryer dhe përfunduar me sukses nga mbajtësi i diplomës etj.
4. Përmbajtja dhe forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga senati akademik, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
5. Çdo formë diplome ose certificate, përpara se të lëshohet, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 65

Titujt e diplomave të ciklit të parë në Akademinë e Arteve

1. Akademia e Arteve lëshon diploma "Bachelor" për ciklin e parë të studimeve sipas programeve të studimit në secilin prej Fakulteteve
2. Me përfundimin e studimeve në Fakultetin e Muzikës lëshohen diploma për përfundimin e programeve të studimit në:
 - a. Muzikologji;
 - b. Kompozim;
 - c. Dirizhim;

- ç. Piano;
 - d. Violinë;
 - dh. Violë;
 - e. Violonçel;
 - ë. Tub;
 - f. Kontrabas;
 - g. Flaut;
 - gj. Klarinetë;
 - h. Oboe;
 - i. Korn;
 - j. Fagot;
 - k. Trombë;
 - l. Trombon;
 - ll. Këngë;
 - m. Kitarë;
 - n. Pedagogji muzikore;
 - nj. Fizarmonikë;
3. Me përfundimin e studimeve në Fakultetin e Artit Skenik lëshohen diploma për përfundimin e programeve të studimit në:
- a. Regji;
 - b. Aktrim;
 - c. Skenografi – Kostumografi;
 - ç. Koreografi;
 - d. Regji Filmi dhe Televizioni.
4. Me përfundimin e studimeve në Fakultetin e Arteve të Bukura lëshohen diploma për përfundimin e programeve të studimit në:
- a. Pikturë Grafik;
 - b. Pikturë Tekstili dhe Mode;
 - c. Pikturë Multimedia;
 - ç. Pikturë Kavaleti;
 - d. Pikturë Monumentale;
 - dh. Skulpturë;
 - e. Skulpturë Qeramike.

Neni 66

Transferimet për ciklin e parë të studimeve

1. Akademia e Arteve ofron mundësi për transferime të studentëve midis programeve të ciklit të parë, brenda Akademisë së Arteve apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme në programe të studimeve të ciklit të parë.
2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.
3. Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Njeshmëria e programit të studimit;
 - b. Koha e kryerjes së studimeve;
 - c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
4. Kriteret kryesore për njohjen e pjesshëm të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Ngjashmëria e programit të studimit;
 - b. Koha e kryerjes së studimeve;

- c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
5. Kriteria të tjera më të detajuara për njohjen e krediteve sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, përcaktohen në rregulloret mësimore të Akademisë së Arteve.

KREU III STUDIMET NË CIKLIN E DYTË

Neni 67

Programet e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve të Bukura”

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë japin njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti;
2. Këto programe realizohen me 120 kredite ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën dhe zgjatja normale e tyre është dy vite;
3. studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;
4. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” në fushën e arsimit të kryer. Lëshimi i diplomave për ciklin e dytë të provimeve bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 63 të këtij Statuti.

Neni 68

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të dytë

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë duhet të përmbajnë të njëjtët elemente që përcaktohen për programet e studimit të ciklit të parë.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit të ciklit të dytë mund të përcaktohen nga Senati akademik.

Neni 69

Pranimi në ciklin e dytë të studimeve

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve individë që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë, si dhe plotësojnë standardet akademike të kriterëve të pranimit të Akademisë së Arteve.
2. Kuotat e pranimit në Akademinë e Arteve, për programet e studimeve të ciklit të dytë, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 70

Standardet akademike të kriterëve të pranimit

1. Kriteret e pranimit për standardet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen duke u bazuar edhe në rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.
2. Kriteria për pranimin janë:
 - a. Rezultatet e arritura gjatë studimeve të ciklit të parë;
 - b. Përputhshmëria apo përafrimi i programeve;
 - c. Aftësi të veçanta në fushën specifike.
3. Kriteria të tjera dhe/ose më të detajuara pranimi përcaktohen në akte të tjera të nxjerra nga autoritetet kompetente për organizimin e studimeve të ciklit të dytë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe duke marrë në konsideratë specifikat e programeve të veçanta.

Neni 71

Transferimet për ciklin e dytë të studimeve

1. Akademia e Arteve ofron mundësi për transferime të studentëve midis programeve të ciklit të dytë, brenda Akademisë së Arteve apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin.
3. Kriteret kryesore për njohjen e plotë të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Njeshmëria e programit të studimit;
 - b. Koha e kryerjes së studimeve;
 - c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
4. Kriteret kryesore për njohjen e pjesshëm të krediteve të grumbulluara nga një student janë si më poshtë:
 - a. Ngjashmëria e programit të studimit;
 - b. Koha e kryerjes së studimeve;
 - c. Të jetë i përfshirë në sistemin e Bolonjës.
5. Kriteria të tjera më të detajuara për njohjen e krediteve sipas pikave 3 e 4 të këtij neni, përcaktohen në rregulloret mësimore të Akademisë së Arteve.

Neni 72

Titujt e diplomave të ciklit të dytë në Akademinë e Arteve

1. Akademia e Arteve lëshon diploma për ciklin e dytë të studimeve sipas programeve të studimit në secilin prej Fakulteteve.
2. Diplomat për çdo Fakultet lëshohen në përputhje me titujt e miratuara, nga autoritetet kompetente. Titujt e diplomave mund të ndryshojnë në varësi të miratimeve sa më sipër.

Neni 73

Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë

Organizimi dhe rregullat për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Akademinë e Arteve bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë miratohen nga autoritetet kompetente shtetërore.

Neni 74

Programi i studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"

1. Programet e studimeve "Master profesional" u ofrojnë të diplomuarve, me një diplomë universitare së paku "Bachelor", arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional;
2. Programet e studimeve "Master profesional" realizohen me 60-90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik;
3. Studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare;
4. Në përfundim të këtyre programeve të studimeve lëshohet diplomë universitare "Master profesional" në fushën e arsimimit e të trajnimit profesional të kryer;
5. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të pranojnë kandidatë që kanë fituar diplomë "Master profesional" në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe të vendosin kriteret për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

KREU IV STUDIMET NË CIKLIN E TRETË

Neni 75 Programet e ciklit të tretë të studimeve

1. Programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese;
2. Në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”, ose një diplomë të njëvlershme me të, si dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga Akademia e Arteve;
3. Këto programe të studimeve zgjasin të paktën 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Akademia e Arteve, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara teorike, vendos kriteret klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin kërkimor dhe të përgatisin tezën e doktoratës. Akademia e Arteve përcakton standarde e kriteret kualifikuese për njohjen e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, si dhe metoda për vlerësimin e nivelit teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre;
4. Në përfundim të programeve të studimeve të doktoratës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” (Dr).

KREU V PROGRAMI I DYTË I STUDIMIT

Neni 76 Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Individët që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve.
2. Këta individë duhet t'i nënshtrohen konkursit për të studiuar në programin e ri, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë statut.

Neni 77 Kriteret për ndjekjen e programit të dytë të studimit

1. Individët që duan të ndjekin një program të dytë të studimit, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 62 të këtij Statuti, duhet të shfaqin njohuri të veçanta që përputhen me programin e studimit që duan të ndjekin në Akademinë e Arteve.
2. Individët sa më sipër duhet të paguajnë tarifën e pranimit dhe shkollimit në përputhje me përcaktimet e akteve nënligjore në fuqi.

KREU VI PROGRAME TË TJERA

Neni 78

Programet e studimeve ndërdisiplinore

6. Fakultetet në Akademinë e Arteve organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore. Programe të tilla organizohen edhe në bashkëpunim me fakultete të institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
7. Në përfundim të programeve të studimeve ndërdisiplinore lëshohet diplomë e përbashkët nga të Akademia e Arteve dhe nga institucioni tjetër i arsimit të lartë.

Neni 79

Programet e studimeve të përbashkëta

1. Programet e studimeve të përbashkëta realizohen në Akademinë e Arteve ose në një prej Fakulteteve të Akademisë së Arteve, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.
2. Programet e studimeve të përbashkëta organizohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë.

Neni 80

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. Në vijim të programeve të ndryshme të studimeve, Akademia e Arteve ofron programe të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës. Këto programe shërbejnë për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive. Ato mund të jenë dhe programe të kërkimit të avancuar.
2. Programet e studimeve të formimit të vazhduar ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe të aftësive profesionale.
3. Në kuadër të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Akademia e Arteve organizon edhe forma të tjera të ndryshme të mësimi informal si kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme.
4. Struktura e programeve, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kohëzgjatja dhe kreditet e tyre përcaktohen nga Akademia e Arteve në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut për programet e studimit.
5. Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, Akademia e Arteve lëshon certifikatat përkatëse.

KREU VII

NJOHJA DHE EKUIVALENTIMI I DIPLOMAVE

Neni 81

Njohja e diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të huaj

1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njësohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e certifikatave, gradave ose titujve të huaj.
2. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të diplomave ose certifikatave, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila e kryen këtë proces nëpërmjet njësisë përgjegjëse të njohjes së diplomave, që funksionon edhe si Qendra Kombëtare e Njohjes së Diplomave dhe e Informimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të autorizojë Akademinë e Arteve për kryerjen e këtij procesi për rastet e njësimit të diplomës nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin. Këto raste

përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë të gradave shkencorë ose titujve akademikë, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, është Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
4. Procedurat dhe kriteret për njohjen e diplomave, certifikatave, gradave e titujve, të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, përcaktohen me akt të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim.

Neni 82

Njohja dhe ekuivalentimi i diplomave dhe i periudhave të studimeve

1. Nëpërmjet ekuivalentimit, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
2. Ekuivalentimi bëhet nga Akademia e Arteve. Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm si dhe procedurat për ekuivalentim përcaktohen në këtë statut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 83

Dokumentacioni për ekuivalentimin

1. Për ekuivalentimin e diplomave dhe periudhave të studimit duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtëm:
 - a. formatin e aplikimit të plotësuar;
 - b. diplomën ose certifikatën/vërtetimin e diplomimit;
 - c. listën e notave;
 - ç. dokument zyrtar identiteti, certifikatë lindjeje origjinale me fotografi dhe fotokopje e pasaportës, ndërsa për shtetasit e huaj: fotokopje e pasaportës dhe kartës së identitetit;
 - d. mandatpagesën.
2. Në çdo rast procedurat për ekuivalentimin nuk do të tejkalojnë kufijtë apo nuk do të jenë më shtrënguese se sa përcaktohet në aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 84

Procedurat për ekuivalentimin

1. Kërkesa për ekuivalentim së bashku me dokumentacionin e nevojshëm paraqiten në Akademinë e Arteve.
2. Dosja i përcillet Fakultetit përkatës, në përputhje me profilin e diplomës së fituar apo studimeve të kryera.
3. Aplikimi nuk pranohet, nëse mungon një nga dokumentet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 80. Dokumentet pranohen origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet e përcaktuara në pikat "b" dhe "c", si dhe në pikën "ç" për shtetasit e huaj, duhet të jenë me përkthim të vërtetuar.
4. Të paktën një nga dokumentet bazë që konfirmon diplomimin apo mbarimin e suksesshëm të kursit të studimit që do njihet, duhet të jetë i legalizuar me vulën Apostille ose nga autoritetet diplomatike/konsullore shqiptare.
5. Dekani i fakultetit përkatës të IAL-së ngre Komisionin e Njohjes dhe kryen njohjen në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në statut dhe në rregulloret e institucionit të arsimit të lartë. Kur vendimi nga fakulteti përkatës i IAL-së nuk përputhet me rekomandimin e lëshuar në certifikatën e njohjes nga MASH-i, fakulteti përkatës i IAL duhet të konsultohet paraprakisht me Komisionin e Njohjes së MASH-it para marrjes së vendimit.
6. Në kuadrin e njohjes dhe vlerësimit merren në konsideratë të drejta akademike jo më pak nga ato që njihen në vendin e origjinës, por asnjëherë jo më shumë se ato që njihen në vendin tonë. Bazë e

vlërësimit të programit dhe kursit të kryer janë lëndët e programit, ngarkesa mësimore (në kredite), vitet e studimit, plotësimi i kuadrit bazë, rezultatet e të mësuarit dhe formimit të marrë, të drejtat akademike dhe profesionale që specifikohen apo nënkuptohen nga kuadri kombëtar i vendit të origjinës, krahasuar kundrejt kuadrit tonë kombëtar.

7. Në rastet e njohjes së pjeshme, duhet argumentuar, bazuar në përcaktimet e pikës 6 më sipër, se ka diferenca substanciale të konsiderueshme.
8. Fakultetet përcjellin zyrtarisht në autoritetet kompetente praktikrat për çdo rast të shqyrtuar.

PJESA E GJASHTË

STUDENTËT E AKADEMISË SË ARTEVE

KREU I STUDENTI DHE STATUSI I TIJ

Neni 85 Statusi i studentit

Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin e tij në Akademinë e Arteve dhe e humbet këtë status me përfundimin e studimeve, si dhe në raste të ndryshme të çregjistrimit të tij. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve përcaktohen në bazë të legjislacionit në fuqi dhe këtij Statuti.

Neni 86 Të drejtat dhe detyrat e studentëve

1. Studentët kanë të drejtë:
 - a. të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
 - b. të përdorin mjedise në biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga Akademia e Arteve;
 - c. të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e Akademisë së Arteve në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi;
 - ç. të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të Akademisë së Arteve;
 - d. të drejta të tjera të përcaktuara në këtë Statut dhe akte të tjera me fuqi në Akademinë e Arteve
2. Studentët kanë detyrë:
 - a. të zbatojnë rregullat e hartuara nga institucioni;
 - b. t'u kushtojnë vëmendjen e duhur studimeve dhe të marrin pjesë në veprimtaritë akademike;
 - c. të paguajnë tarifat e shkollimeve dhe të shërbimeve që u ofrojnë institucionet;
 - ç. të respektojnë kodin e etikës;
 - d. të tregojnë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.
 - dh. detyra të tjera të përcaktuara në këtë Statut dhe akte të tjera me fuqi në Akademinë e Arteve;

Neni 87 Karta e studentit

1. Studentët e Akademisë së Arteve pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.

2. Kriteret dhe procedurat për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit në Akademinë e Arteve përcaktohen nga senati akademik, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
3. Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Kategoritë e shërbimeve që ofrojnë entet shtetërore bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje me organizma që kanë objekt të tyre interesat studentorë e me persona juridikë privatë që ofrojnë shërbime të ndryshme.

Neni 88
Bursa për studime

1. Studentët e institucioneve publike të arsimit të lartë përfitojnë bursa si mbështetje ekonomike për studimet e tyre, si dhe stimuj materialë për rezultate të shkëlqyera.
2. Bursat, sipas pikës 1 të këtij neni, përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe donacione të ligjshme. Këshilli i Ministrave përcakton kriteret shtetërore dhe procedurat për përfitimin e bursave.
3. Në Akademinë e Arteve ndarja e bursave bëhet nga një komision *ad hoc* i ngritur me urdhër të Rektorit të Akademisë së Arteve.

Neni 89
Regjistri i studentëve

1. Akademia e Arteve mban regjistrin bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës, etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.
2. Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme.
3. Çdo student, në regjistrimin fillestar në Akademinë e Arteve, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës. Gjenerimi dhe dhënia e numrave të matrikullimit bëhet sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 90
Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që në përfundim të studimeve të plota kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë "Medaljen e Artë" me certifikatën përkatëse. Ata që kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta (10) e pjesën tjetër nënta (9), fitojnë certifikatën "Student i Shkëlqyer".
2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet. Për studentët që fitojnë "Medaljen e Artë" ose certifikatën "Student i Shkëlqyer", ceremonia organizohet në shkallë akademie dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori në prani të përfaqësuesve të senatit, të profesoratit, administratës dhe studentëve.

KREU II
KËSHILLAT E STUDENTËVE

Neni 91
Këshillat e studentëve

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve që ngrihen në Akademinë e Arteve. Këta këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të

shërbimeve.

2. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
3. Këshillat e studentëve nuk mund të organizohen me struktura të tjera politike e jopolitike, jashtë institucioneve përkatëse të arsimit të lartë.

Neni 92

Zgjedhja e Këshillave studentorë

1. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve të Akademisë së Arteve, ose sipas rastit të Fakultetit përkatës. Në rastet kur një individ i zgjedhur në këshillat e studentëve përfundon studimet universitare, ai zëvendësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit
2. Rregullat dhe procedurat për zhvillimin e zgjedhjeve përcaktohen në Rregulloren e Zgjedhjeve në Akademinë e Arteve dhe në rregulloret e miratuara nga vetë këshillat studentorë.

Neni 93

Organizimi i Këshillave Studentorë

1. Këshillat e studentëve organizohen në nivel fakulteti (këshilli i studentëve të fakultetit) dhe në nivel Akademi (këshilli i studentëve të institucionit).
2. Organet drejtuese të këshillave të studentëve përcaktohen dhe zgjidhen nga anëtarësia e këshillave studentorë.
3. Këshillat studentorë hartojnë rregulloret e detajuara për funksionimin e tyre. Këto rregullore duhet të përmbajnë dispozita edhe për mënyrën e zgjedhjes së studentëve përfaqësues në organet drejtuese të akademisë së Arteve.
4. Rregulloret sipas pikës 4 të këtij neni duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Akademisë së Arteve.
5. Akademia e Arteve mbështet këshillat e studentëve dhe financon veprimtarinë e tyre, në përputhje me rregullat për përdorimin e fondeve buxhetore dhe për atë sa lejojnë të ardhurat e Akademisë së Arteve.

PJESA E SHITATË

PUNËSIMI NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 94

Personeli i Akademisë së Arteve

1. Personeli akademik gëzon status të veçantë. Përveç sa parashikohet në aktet ligjore për arsimin e lartë, Këshilli i Ministrave rregullon me vendim të tij aspektet e trajtimit të veçantë dhe përfitimeve të tjera për personelin akademik.
2. Personeli i Akademisë së Arteve përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe personeli administrativ.
3. Detyrat dhe të drejtat e personelit të Akademisë së Arteve përcaktohen në këtë statut dhe në rregulloret me fuqi në Akademinë e Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Këshilli i Administrimit miraton numrin e punonjësve për secilën njësi të Akademisë së Arteve sipas propozimeve të Rektorit, bazuar në numrin e përgjithshëm të personelit të Akademisë së Arteve, të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

KREU I PERSONELI AKADEMIK

Neni 95 Përbërja e personelit akademik

Në Akademinë e Arteve personeli akademik përfshin:

- a. Personel akademik i brendshëm;
- b. Personel ndihmës mësimor shkencor;
- c. Personel akademik i ftuar;
- ç. Personel akademik me kontratë.

Neni 96 Personeli akademik dhe titujt akademikë

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkim shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillim, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në rregulloret e Akademisë së Arteve dhe janë pjesë e kontratave të punës mes palëve.
2. Personeli akademik në institucionet e arsimit të lartë, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:
 - a. “Profesorë”, që përfshin anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus”, “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik”;
 - b. Në kategorinë “Docentë” janë anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë titullin akademik “Docent” ose gradën shkencore “Doktor”;
 - c. Në kategorinë “Lektorë” janë anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore. Lektorët duhet të kenë diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve të Bukura” dhe të përmbushin kriteret që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në programet e studimeve jouniversitare , lektorët duhet të kenë diplomën “Master Profesional”
3. Ndarja në nivele, brenda secilës kategori, emërtimi dhe renditja e tyre, si dhe kriteret më të hollësishme kualifikimi për secilin rast përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, referuar edhe përshkrimit të vendit të punës.
4. Shfuqizuar
5. Niveli i pagave, sipas kategorive dhe vendeve të punës, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Titulli “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus” dhe “Docent” jepen nga Akademia e Arteve në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë statut. Titulli “Profesor” jepet nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë. Titulli “Akademik i Asociuar” dhe “Akademik” jepet nga Akademia e Shkencave në përputhje me ligjin “Për Akademinë e Shkencave”. Titulli “Docent” u jepet anëtarëve të personelit akademik që kanë gradën shkencore “Doktor”. Ai u jepet edhe anëtarëve të personelit akademik me diplomë “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”,

ose ekuivalent i saj në vende të tjera, të vlerësuar me rezultatin “shumë mirë” ose “shkëlqyer” dhe që kanë veprimtari mësimore-kërkimore në një institucion të arsimit të lartë prej së paku 5 vitesh, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve akademikë “Docent”, “Profesor i asociuar”, “Profesor” dhe “Profesor emeritus” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Neni 97

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor, këshillat e fakulteteve, me propozim të departamenteve, ftojnë për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme. Te kjo kategori përfshihen edhe studiues, artistë dhe personalitete me kontribut të shquar jashtë vendit.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.
3. Përgjegjësi i departamentit përkatës i paraqet dekanit të fakultetit numrin e personelit akademik për t'u ftuar, temat ose lëndët e modulet përkatëse, si dhe orët mësimore që do të kryejnë.
4. Dekani i njofton rektoratit numrin e personelit akademik të ftuar, temat ose lëndët përkatëse si dhe kriteret e të ftuarit, dhe pasi merr miratimin prej Rektoratit e bën funksionale këtë marrëdhënie.
5. Kontratat e punës nënshkruhen nga punonjësi akademik i ftuar dhe Rektori i Akademisë së Arteve.
6. Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e Akademisë së Arteve
7. Kriteria të detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e lektorëve të ftuar përcaktohen në rregulloret e fakulteteve.

Neni 98

Personeli akademik me kontratë

1. Akademia e Arteve ka të drejtë të punësojë me kontratë personalitete, vendase ose të huaja, për periudha të shkurtra kohe. Ky personel punësohet me vendim të senatit akademik, sipas propozimeve të Dekanit me kërkesë të Departamenteve.
 - 1.1 Autoritetet drejtuese të njësive kryesore, me propozimin e përgjegjësve të njësive bazë dhe të titullarit të grupit mësimor kërkimor, për të plotësuar nevojat, punësojnë personel akademik me kohë të plotë për veprimtari mësimore e kërkimore, për periudha semestrale ose njëvjeçare të përsëritshme, sipas kërkesave të vendit të punës.
 - 1.2 Akademia e Arteve ka të drejtë të punësojë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, edhe studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe të përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore “Doktor”, të cilët mbështesin profesorët udhëheqës të disertacionit në procesin mësimor dhe gjatë kësaj periudhe trajtohen si “Lektor”.
2. Propozimi i Dekanit duhet të jetë i argumentuar me nevojën e fakultetit për kontributin e atij personaliteti, me kualifikimet e tij në fushën e artit si dhe me mundësinë për përballimin e shpenzimeve nga të ardhurat e Akademisë së Arteve.
3. Kriteret e punësimit përcaktohen në këtë statut dhe rregulloret e Akademisë së Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Kontratat e punës nënshkruhen nga punonjësi akademik dhe Rektori i Akademisë së Arteve.
5. Shpenzimet për personelin akademik me kontratë përballohen nga të ardhurat e Akademisë së Arteve. Paga e personelit akademik me kontratë përcaktohet me vendim të Këshillit të Administrimit.

Neni 99

Kriteret e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik punësohet me kohë të plotë ose të pjesshme. Për personelin akademik "Profesor", "Docent", "Lektor" kriteret minimale të punësimit vendosen rast pas rasti në përputhje me përcaktimet e akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
2. Kriteret për punësim, në çdo rast bëhen publike, nga Rektorati dhe/ose nga Fakulteti përkatës.

Neni 100

Procedurat e punësimit

1. Marrja në punë e personelit akademik në Akademinë e Arteve kryhet me konkurrim publik.
2. Për vendet e lira konkurrimi shpallet nga Rektorati, duke përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta. Për vendet e lira në Fakultete, Dekani përkatës përgatit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat ia njofton Rektorit. Rektorati bën shpalljen përkatëse.
3. Vlerësimi i kandidatëve që konkurrojnë për një vend në personelin akademik të Akademisë së Arteve, bëhet nga komisione të posaçme. Komisionet ngrihet me urdhër Dekanit të Fakultetit. Për ngritjen e Komisionit, Dekani emëron 2/3 e anëtarëve të Komisioneve pasi përzgjedh ndër personelin akademik të Fakultetit, me dije në fushën për të cilën zhvillohet konkursi. Dekani emëron 1/3 e anëtarëve të Komisionit, personat e caktuar nga Rektori dhe të njoftuar me akt zyrtar.
4. Kualifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura publikisht. Eksperienca dhe formimi i kandidatëve të kualifikuar duhet ti përgjigjen sa më mirë përshkrimit të vendit të punës.
5. Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht, prej secilit prej anëtarëve dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
6. Rezultatet e vlerësimit dhe renditja e aplikantëve shpallen publikisht. Aplikantëve u garantohej e drejta të ankimojnë vlerësimin dhe rezultatet e konkursit, duke paraqitur kërkesë formale dhe duke parashtruar arsyet dhe shkaqet për të cilat paraqesin ankimin, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve. Ankimi paraqitet tek Rektori i Akademisë së Arteve, i cili e shqyrton dhe vendos mbi ankimin brenda 30 ditëve. Gjatë shqyrtimit të ankimeve zbatohen nga pikëpamja e së drejtës procedurat e përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
7. Për emërimin e personelit akademik, autoriteti drejtues i njësisë kryesore i paraqet autoritetit drejtues të institucionit të arsimit të lartë kandidatin e renditur i pari në klasifikimin e bërë nga komisioni ad hoc i konkursit publik, i krijuar nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore. Autoriteti drejtues i institucionit të arsimit të lartë lidh kontratë pune me kandidatin e përzgjedhur, mbështetur në këtë ligj dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 96 të këtij Statuti.
8. Mësimdhënia është detyrim, si rregull, me së paku 6 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik

Neni 101

Fillimi i marrëdhënieve të punës

1. Kandidatët fitues lidhin kontratë pune me Rektoren e Akademisë së Arteve, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për arsimin e lartë dhe legjislacionin e punës në fuqi.
2. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe të drejtat e detyrimet e personelit akademik, sipas këtij statuti dhe akteve të tjera me fuqi në Akademinë e Arteve.

Neni 102

Të drejtat e personelit akademik

1. Në Akademinë e Arteve personeli akademik ka këto të drejta:
 - a. Të ushtrojë funksionimin mësimdhënës dhe të kërkimit artistik e shkencor, në liri të plotë akademike;
 - b. Të ketë një punë të garantuar;
 - c. Të mos cenohet, pengohet apo kufizohet në çfarëdo forme gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
 - ç. Të paguhet sipas kualifikimeve shkencore për orët shtesë, për çdo punim, shërbim apo detyrë tjetër, për të cilën fakulteti ka krijuar të ardhura;
 - d. Të kryejë lejen vjetore të paguar;
 - dh. Të përfitojë vitin akademik sabbatik, me plotësimin e kushteve përkatëse;
 - e. Të kryejë kualifikime artistike e shkencore periodike afatshkurtra apo afatgjata brenda apo jashtë vendit;
 - ë. Të kryejë detyra të tjera jashtë funksionit bazë, pa shkaktuar konkurrencë apo konflikt interesi me Akademinë e Arteve
 - f. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Akademinë e Arteve, ka të drejtë, me miratimin e titullarit të njësisë kryesore dhe të Rektorit, të angazhohet si personel akademik i ftuar me kohë të pjesshme, në një institucion tjetër të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda dhe jashtë vendit.
2. Të drejta të tjera të personelit akademik mund të përcaktohen nga legjislacioni në fuqi apo akte të tjera me fuqi në Akademinë e Arteve.

Neni 103

Detyrimet e personelit akademik

1. Në Akademinë e Arteve, personeli akademik ka këto detyrime:
 - a. të zbatojë legjislacionin në fuqi, për arsimin e lartë, gjatë ushtrimit të detyrës të përmbushë detyrën e ngarkuar, si: ngarkesën mësimore, kërkimin artistik e shkencor, etj., në përputhje me kontratën e punës;
 - b. t'i deklarojë punëdhënësit, sa herë kryen punë të dytë që mund të krijojë konkurrence apo konflikt interesi me detyrën që ushtron;
 - c. të jetë i aftë të punojë në grup, të bashkëpunojë me kolegët dhe studentët.
2. Të drejta të tjera të personelit akademik mund të përcaktohen nga legjislacioni në fuqi apo akte të tjera me fuqi në Akademinë e Arteve.

Neni 104

Norma mësimore dhe mbingarkesa

1. Mësimdhënia është detyrim, si rregull, me së paku 6 orë mësim në javë në auditor për të gjithë personelin akademik. Ngarkesa e plotë për personelin akademik në institucionet publike të arsimit të lartë përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
2. Personelit akademik paguhet për orët mësimore të realizuara mbi normën, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 105

Viti akademik sabbatik

1. Në Akademinë e Arteve, personeli akademik me tituj ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik, pas miratimit të këshillit të fakultetit të njësisë kryesore. Autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë nuk kanë të drejtë për vit

sabatik gjatë kohës së ushtrimit të mandatit si drejtues, i zgjedhur apo i emëruar. Gjatë kësaj periudhe personelit akademik nuk i ngarkohet detyrë mësimdhënie.

2. Personeli akademik mund të ndjekë gjatë këtij viti edhe kurse specializimi brenda ose jashtë vendit.
3. Midis anëtarit të personelit akademik të interesuar dhe Rektorit të Akademisë së Arteve nënshkruhet një kontratë, ku përcaktohen në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 106

Përfundimi i marrëdhënieve të punës së personelit akademik

1. Personelit akademik i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur:
 - a. Mbush moshën për daljen në pension;
 - b. Ndërron jetë;
 - c. Jep dorëheqjen;
 - ç. Nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë;
 - d. Shkel rregullat e etikës së jetës akademike, të statutit dhe rregulloreve të Akademisë së Arteve.dh. Dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
2. Personeli akademik me titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur me kërkesën e tij lirohet nga detyra.
3. Personeli akademik me titull “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh, të rinovueshme, për t’u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Këtu përfshihen edhe pozicionet drejtuese të agjencive të rëndësishme të sistemit të arsimit dhe shkencës. Për periudhën e shkëputjes, ky personel akademik mund të zëvendësohet nga personel akademik me kontratë të përkohshme ose nga personel akademik i ftuar.

KREU II

PERSONELI ADMINISTRATIV

Neni 107

Personeli administrativ

1. Akademia e Arteve rekruton personel administrativ të kategorive të ndryshme në përputhje me nevojat e veta.
2. Numri i punonjësve administrativ përcaktohet me vendim të këshillit të administrimit, pa tejkaluar numrin e përgjithshëm të të punësuarve të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
3. Rektori i Akademisë së Arteve harton strukturën organizative të personelit administrativ dhe ia paraqet për miratim Këshillit të administrimit.
4. Rektori miraton përshkrimet e pozicioneve të punës në administratën e Akademisë së Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Personeli administrativ në Akademinë e Arteve trajtohet në përputhje me aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 108

Rekrutimi i personelit administrativ

1. Personeli administrativ në Akademinë e Arteve rekrutohet në bazë të konkurrimit të lirë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi. Rektorati merr masat e nevojshme për publikimin e konkursit dhe kriterëve të konkurrimit.

2. Kriteret e përgjithshme për pozicionet e punës janë si vijon:
 - a. Për pozicionet e punës me funksione drejtuese, kandidatët duhet:
 - i. Të kenë kryer arsimin e lartë në fushën përkatëse që mbulon veprimtarinë e pozicionit përkatës të punës;
 - ii. Të njohin një gjuhë të huaj të komunitetit evropian;
 - iii. Të mos jenë dënuar për kryerjen e ndonjë krimi, me vendim gjykate të formës së prerë, apo të jenë në proces gjykimi për kryerjen e një vepre penale;
 - b. Për pozicionet e punës me funksion specialist, kandidatët duhet:
 - i. Të kenë kryer arsimin e lartë në fushën përkatëse që mbulon veprimtarinë e pozicionit përkatës të punës;
 - ii. Të mos jenë dënuar për kryerjen e ndonjë krimi, me vendim gjykate të formës së prerë, apo të jenë në proces gjykimi për kryerjen e një vepre penale;
 - c. Për pozicionet e punës teknik i mesëm, kandidatët duhet:
 - i. Të kenë kryer arsimin e mesëm në fushën përkatëse që mbulon veprimtarinë e pozicionit përkatës të punës;
 - ii. Të mos jenë dënuar për kryerjen e ndonjë krimi, me vendim gjykate të formës së prerë, apo të jenë në proces gjykimi për kryerjen e një vepre penale;
3. Rektorati përcakton kritere të tjera më specifike për çdo pozicion pune, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, si dhe kriteret për vendet e punës që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij neni.
4. Procedurat për vlerësimin dhe shpalljen e rezultatit të konkurseve, si dhe për ankimimin janë të njëjta me ato të përcaktuara për personelin akademik.

Neni 109

Të drejtat dhe detyrat e personelit administrativ

1. Personeli administrativ në Akademinë e Arteve ka këto të drejta kryesore:
 - a. Të ketë një punë të garantuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b. Të paguhet për punën e kryer në përputhje me kontratën e punës të nënshkruar, si dhe për punën e kryer jashtë orarit;
 - c. Të përfitojë leje të paguar për pushime vjetore, lejet e lindjes, lejet në raste gëzimesh apo fatkeqësish, ditët e pushimeve zyrtare dhe festave zyrtare apo leje të papaguar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç. Të ushtrojë veprimtari të tjera të ligjshme, jashtë detyrës dhe kohës së punës,
 - d. Të punojë për përparimin e vet profesional, pa cenuar marrëdhëniet e punës;
 - dh. Çdo të drejtë tjetër të parashikuara në këtë statut apo rregulloret e Akademisë së Arteve, si dhe në legjislacionin në fuqi.
2. Personeli administrativ ka këto detyra kryesore:
 - a. Të njohë dhe të zbatojë legjislacionin e arsimit të lartë dhe legjislacionin që lidhet me fushën specifike të veprimtarisë që mbulon;
 - b. Të sigurojë për publikun informacion që lidhet me fushën e veprimtarisë së tij, në përputhje me këtë statut dhe rregulloret me fuqi në Akademinë e Arteve, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me informacion sekret shtetëror, konfidencial apo për përdorim të brendshëm.
 - c. Të shfaqë standarde të larta etike dhe profesionale, të komunikimit dhe sjelljes ndërpersonale dhe të promovojë imazhin pozitiv për Akademinë e Arteve;
 - ç. Të mos kërkojë apo pranojë asnjë përfitim moral apo material, për kryerjen e detyrave, me përjashtim të pagës dhe shpërblimeve të tjera të parashikuara me ligj;
 - d. Të mos zbatojnë asnjë urdhër të paligjshëm dhe të raportojë për dhënien e urdhrave të tillë, tek organet më të larta drejtuese në Akademinë e Arteve;
 - dh. Të mos kryejë asnjë veprimtari, e cila përbën konflikt interesi me detyrën zyrtare dhe të informojë autoritetet përkatëse në Akademinë e Arteve në rastet e konstatimit të

konfliktit të interesit;

- e. Të mos përdorë pronën shtetërore për përfitime vetjake të çfarëdolloj forme;
- ë. Detyra të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi, ky statut dhe rregulloret e Akademisë së Arteve.

Neni 110

Masat disiplinore dhe procedura e dhënies së masave disiplinore

1. Për personelin administrativ në Akademinë e Arteve jepen këto masa disiplinore:
 - a. Vërejtje;
 - b. Vërejtje me paralajmërim;
 - c. Largim nga detyra.
2. Masat disiplinore për personelin administrativ jepen nga Rektori i Akademisë së Arteve, me iniciativën e tij, me propozim të Kancelarit të Akademisë së Arteve apo të eprorëve direkt për vartësit, në përputhje me strukturën organike të personelit administrativ. Procedura për dhënien e masës disiplinore duhet të garantojë të drejtën për tu informuar, për tu dëgjuar dhe për tu mbrojtur për punonjësin.
3. Procedura e dhënies së masës disiplinore të përcaktuar në geramat a dhe b të pikës 1 të këtij neni është si më poshtë:
 - a. Personat e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, i propozojnë Rektorit dhënien e masës disiplinore, duke përcaktuar qartësisht emrin dhe mbiemrin si dhe pozicionin e punës së punonjësit, ndaj të cilit propozohet dhënia e masës disiplinore. Propozuesi përcakton gjithashtu, shkeljet e konstatuara dhe arsyet përse propozohet dhënia e masës disiplinore;
 - b. Rektori, pasi konsideron propozimin, nxjerr urdhër për fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore. Urdhri përcakton punonjësin ndaj të cilit fillon procedura, si dhe arsyet për fillimin e procedurës. Urdhri përcakton edhe afatin kohor brenda të cilit punonjësi duhet të paraqesë mbrojtjen dhe argumentet e tij. Punonjësit i lihet një afat prej 10 ditësh.
 - c. Rektori, pasi administron praktikën e propozimit, së bashku me mbrojtjen dhe argumentat e punonjësit, mund të kërkojë dokumente apo prova të tjera shkruesore, apo edhe të pyesë punonjës apo autoritete të tjera lidhur me çështjen.
 - ç. Rektori brenda 30 ditësh nga paraqitja e mbrojtjes së punonjësit, pasi ka shqyrtuar praktikën përkatëse, merr vendim për dhënien e masës disiplinore ose jo. Mos shprehja nga ana e Rektorit brenda këtij afati, konsiderohet si refuzim i propozimit për dhënien e masës disiplinore.
 - d. Vendimi i rektorit për dhënien ose jo të masës disiplinore shprehet me Urdhër, i cili i bëhet i njohur propozuesit për dhënien e masës disiplinore, si dhe punonjësit ndaj të cilit u zhvillua procedura.
 - dh. Akti për dhënien e masës disiplinore mund të ankimohet në gjykatë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kodi i Procedurave Administrative dhe Kodi i procedurës civile.
4. Procedura e dhënies së masës disiplinore largim nga detyra bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Kodi i Punës.
5. Masat disiplinore të dhëna ndaj punonjësve administrativë duhet të jenë në përputhje me shkeljen e kryer. Rregulla më të detajuara mbi procedurën e dhënies së masave disiplinore mund të përcaktohen në rregullore të Akademisë së Arteve.

Neni 111

Zgjidhja e kontratës së punës

1. Kontrata e punës së personelit përfundon në rastet e mëposhtme:
 - a. Kur mbaron afati i saj;

- b. Kur punëmarrësi jep dorëheqjen;
 - c. Mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
 - ç. Ndërron jetë;
 - d. Bëhet i paaftë nga ana fizike apo mendore për të ushtruar detyrën;
 - dh. Dënohet me vendim gjykate të formës së prerë;
 - e. Merr masën disiplinore të largimit nga detyra;
 - ë. Në të gjitha rastet e tjera që parashikohen shprehimisht në kontratën e punës;
2. Në çdo rast përfundimi i marrëdhënieve të punës bëhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga Kodi i Punës.
 3. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës të personelit akademik bëhet vetëm pasi është marrë mendimi i titullarit të grupit mësimor kërkimor, si dhe i autoriteteve drejtuese të njësisë bazë e të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, përjashtuar rastet e shkeljes flagrante të Kodit të Punës dhe të etikës akademike.

PJESA E TETË

SIGURIMI I CILËSISË NË AKADEMINË E ARTEVE

Neni 112

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

1. Senati Akademik i Akademisë së Arteve vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, në përputhje me standardet shtetërore.
2. Senati Akademik ngre Komitetin e Sigurimit të Cilësisë, i cili ka në përbërje:
 - a. Të paktën tre anëtar të Senatit Akademik;
 - b. Një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve;
 - c. Një ekspert i jashtëm.
3. Komiteti vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore apo artistike, si dhe të veprimtarive administrative e financiare të institucionit. Komiteti ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit.
4. Kriteret dhe procedurat për ngritjen dhe funksionimin e këtij sistemi hartohen nga Akademia e Arteve, në bashkëpunim me Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bazuar në standardet shtetërore të cilësisë.
5. Rezultatet e vlerësimit që kryen Komiteti i Sigurimit të Cilësisë bëhen publike.

Neni 113

Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit, në përputhje me afatet, procedurat dhe nga autoritetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 114

Akreditimi

1. Akreditimi kryhet në përputhje me procedurat, afatet dhe nga organet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Çdo program/institucion i akredituar i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik. Vlerësimi dhe akreditimi periodik kryhet çdo 6 vjet.
3. Shpenzimet për vlerësimin e jashtëm të cilësisë përballohen nga vetë institucionet e arsimit të lartë.
4. Rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit bëhen publike.

PJESA E NËNTË

KËRKIMI SHKENCOR DHE SHËRBIMET E AKADEMISË SË ARTEVE

Neni 115

Kërkimi shkencor dhe zhvillimi

1. Akademia e Arteve mund të kryejë kërkim shkencor, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese, sipas objektivave specifike të Akademisë së Arteve.
2. Veprimtaria e kërkimit dhe zhvillimit që kryhet në Akademinë e Arteve, synon dhe në rritjen e cilësisë së arsimimit. Ajo u jep studentëve aftësi metodologjike për kërkim, jep mundësi të vazhdueshme në plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri të avancuara, përmirëson kualifikimet e personelit akademik, si dhe krijon mjete materiale.
3. Personeli akademik është i lirë të kryejë veprimtari kërkimi e zhvillimi për të tretë, por me kusht:
 - a. plotësimin e detyrimeve sipas kontratës së punës;
 - b. plotësimin e detyrimeve të fakultetit apo departamentit përkatës për kërkim shkencor.
4. Veprimtaritë e kërkimit e zhvillimit për të tretët, realizohen në Akademinë e Arteve vetëm në kuadër të marrëveshjeve me subjekte shtetërore apo private, vendase apo të huaja, në të cilat është palë Akademia e Arteve.
5. Marrëveshjet miratohen nga senati akademik në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë statut.

Neni 116

Veprimtaritë kërkimore

1. Veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit duhet të sigurojnë integrimin e kërkimit me mësimin.
2. Temat ose afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga Departamentet dhe Fakultetet. Këto përcaktohen mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, rëndësinë e kërkimit për arsimimin e studentëve, programet e bashkëpunimit shkencor, aftësimin e personelit akademik, si dhe burimet financiare në dispozicion.
3. Akademia e Arteve kryen për të tretë edhe shërbime të ndryshme të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, shërbime informacioni etj., në përputhje me rregulloret e Fakulteteve.
4. Këto veprimtari kryhen me financime të palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari konsiderohen të ardhura nga institucioni. Një pjesë e këtyre të ardhurave mund të përdoren edhe për shpërblimin dhe motivimin e personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Akademia e Arteve ka të drejtë të hartojnë programe dhe projekte kërkimore të bashkëpunimit me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj.
6. Akademia e Arteve përgatit një raport vjetor për veprimtarinë kërkimore-shkencore ose krijuese të çdo lloji.

Neni 117

Planifikimi i veprimtarive kërkimore

1. Veprimtaritë kërkimore bëhen mbi bazën e planeve, programeve dhe projekteve të miratuara, nga Këshillat e Fakulteteve.
2. Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga Këshillat e Fakulteteve dhe nga Senati Akademi, në përputhje me rregullat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të këtij Statuti.
3. Programet e studimeve të ciklit të tretë dhe, në masë më të vogël, programet e studimeve të ciklit të dytë konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen gjithashtu planifikimit.

PJESA E DHJETË

BUXHETI DHE ÇËSHTJE FINANCIARE

Neni 118

Parime të përgjithshme

1. Të ardhurat e krijuara nga Akademia e Arteve përdoren tërësisht prej saj dhe pjesa e papërdorur e tyre mbartet në vitin pasardhës.
2. Transferrat e pakushtëzuara, që Buxheti i Shtetit akordon në vitin buxhetor pasardhës për Akademinë e Arteve, do të përcaktohen duke marrë në konsideratë edhe pjesën e këtyre transfertave që do të mbarten nga viti paraardhës.
3. Të gjitha transaksionet e arkëtimeve, përfshirë dhe të ardhurat e veta, si dhe ato të pagesave kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit, duke respektuar të gjitha rregullat e kontrollit financiar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Këshilli i Ministrave, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe opinioni publik kanë të drejtë të kërkojnë transparencë të plotë për përdorimin e këtyre të ardhurave, si dhe financimeve nga Buxheti i Shtetit. Ky informacion përfshihet në raportin vjetor të Akademisë së Arteve, që i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe bëhet publik.

Neni 119

Burimet e financimit

1. Akademia e Arteve financohet nga:
 - a. transfertat nga Buxheti i Shtetit;
 - b. të ardhura të krijuara nga Akademia e Arteve;
 - c. burime të tjera me destinacion.
2. Akademia e Arteve miraton rregulloren mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 120

Të ardhurat e Akademisë së Arteve

1. Në të ardhurat e Akademisë së Arteve përfshihen:
 - a. tarifatat e studimeve;
 - b. të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
 - c. të ardhura nga shërbimet në fushën e artit dhe kulturës;
 - ç. të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
 - d. të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim të palëve të treta në trajtën e

- kontratave të qiradhënies dhe me forma të tjera kontraktimi;
dh. dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
e. financimet e pakthyeshme, të marra nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
ë. financime të tjera të ligjshme.
2. Të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni derdhen tërësisht në llogarinë e Akademisë së Arteve dhe përdoren nga vetë ajo.

Neni 121

Hartimi i buxhetit të Akademisë së Arteve

1. Projektbuxheti i Akademisë së Arteve hartohet nga rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse, si dhe miratohet nga senati akademik, pasi miratohet prej këshillit të administrimit.
2. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave. Projektbuxheti i përcillet Ministrin të Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 30 ditëve ushtron kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.
3. Akademia e Arteve ka të drejtë të detajojë dhe të miratojë buxhetin e vet vjetor sipas rektoratit, fakulteteve, departamenteve, dhe njësisve të tjera, në përputhje me rregulloren përkatëse. Të gjitha këto njësi janë autonome në administrimin e buxhetit të tyre, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Rregullat e administrimit financiar të Akademisë së Arteve janë të njëjta me ato të institucioneve të tjera publike.

Neni 122

Kontrolli dhe auditimi i brendshëm

1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në Akademinë e Arteve realizohet nga struktura administrative e auditit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
2. Akademia e Arteve ngre brenda strukturës organizative të saj edhe një strukturë për auditin e brendshëm të Akademisë. Kjo strukturë ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me dispozitat e zbatueshme për auditimin financiar.
3. Auditimi i brendshëm në Akademinë e Arteve përpunon informacione dhe harton në mënyrë periodike raporte mbi veprimtarinë financiare dhe zbatimin e legjislacionit financiar nga strukturat përgjegjëse në Akademinë e Arteve dhe ia paraqet këto raporte autoriteteve drejtuese të Akademisë së Arteve. Raportet përfshijnë edhe rekomandime lidhur me marrjen e masave për rregullimin e situatave financiare dhe përcaktimin e përgjegjësive, kur është rasti. Periudhat periodike të raportimit përcaktohen nga vetë autoritetet drejtuese të cilat presin raportimin.
4. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

Neni 123

Pronat e paluajtshme të Akademisë së Arteve

1. Pronat e paluajtshme publike, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, kalojnë në administrim të Akademisë së Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rektorati i Akademisë së Arteve merr masat për përgatitjen e praktikave përkatëse për kalimin e titullit të pronësisë të pronave të paluajtshme në emër të vet.
2. Akademia e Arteve mirëmban dhe përdor për interesat e veta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pronat e paluajtshme publike që u janë lënë në administrim. Ato hipotekohen në pronësi të

shtetit për përdorim nga Akademia e Arteve.

PJESA E NJËMBËDHJETË

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 124

Miratimi i statutit

1. Ky statut miratohet nga Senati Akademik i Akademisë së Arteve.
2. Statuti i Akademisë mund të ndryshohet, sipas procedurave dhe me shumicën e kërkuar në këtë Statut.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti shfuqizohet çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë në Akademinë e Arteve si dhe çdo dispozitë e rregulloreve apo akteve të tjera, që janë në kundërshtim me këtë statut.

Neni 125

Dispozitat e përkohshme

1. Studentët e regjistruar në një program studimi, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë studimet e tyre me të njëjtin program studimi për kohëzgjatjen normale të tij.
2. *Shfuqizuar*
3. Dispozitat e përkohshme të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë janë të zbatueshme në Akademinë e Arteve, pavarësisht përcaktimeve në këtë statut.
4. Dispozitat e statutit që janë në kundërshtim me dispozitat kalimtare të legjislacionit në fuqi, nuk janë të zbatueshme. Këto dispozita të statutit hynë në fuqi, në momentin e përfundimit të efekteve ligjore të dispozitave kalimtare, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 126

Ekuivalentimi i titujve të diplomave

1. Diplomat e nivelit të parë (DNP), të lëshuara ose të ekuivalentuara me to, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Bachelor".
2. Diplomat e nivelit të dytë (DND) dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë (DIND), që kanë grumbulluar në studimet universitare, së paku, 300 kredite, të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave" dhe "Master i arteve të bukura".
3. Diplomat e studimeve universitare, që kanë zgjatur së paku 4 vite akademike (tetë semestra), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master i shkencave" dhe "Master i arteve të bukura".
4. Diplomat "Master i Nivelit të Parë" (MNP), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare "Master profesional".
5. Studimet universitare, në kuadër të programeve të deritanishme të Shkollës Pasuniversitare të Studimeve të Thelluara (SHPU) dhe "Master i Nivelit të Dytë" (MND) njihen si të barasvlershme me diplomat universitare për specializime apo kualifikime postmaster. Këto studime mund të njihen, pjesërisht ose plotësisht, për studimet e doktoratës.